



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. Prot : 2711

VENDIM

Dt. 08.06.2021

Nr. 38 , Datë 08/06/2021

“PËR MIRATIMIN E  
PROCEDURAVE DHE RREGULLAVE TË VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE  
VEPRIMTARISË PROFESIONALE TË INSPEKTORËVE”

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 212 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e procedurave dhe rregullave të vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale të inspektoreve.
2. Ngarkohet Komisioni i Emërimit dhe Vlerësimit, inspektorët dhe Sekretariati Teknik me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË



KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1  
**Objekti i vlerësimit**

Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i procedurës dhe rregullave të zbatueshme nga Komisioni i Emërimit dhe Vlerësimit, (KEV), kriteret etike dhe profesionale, burimet dhe nivelet e vlerësimit të performancës së inspektorëve.

Neni 2  
**Sistemi i vlerësimit të performancës**

Tërësia e burimeve të vlerësimit, kriterëve të vlerësimit etiko - profesional dhe rregullave proceduriale të vlerësimit, përbëjnë sistemin e vlerësimit të performancës për inspektorët e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 3  
**Qëllimi i vlerësimit**

1. Sistemi i vlerësimit të performancës profesionale ka për qëllim:
  - a) të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme etikën dhe aftësitë profesionale të inspektorëve;
  - b) të vendosë standarde të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e veprimtarisë së inspektorëve;
  - c) të evidentojë dhe të rrisë vlerat profesionale dhe integritetin e inspektorëve, si pjesë e rëndësishme e statusit të tyre edhe për efekt të karrierës profesionale në vazhdimësi, duke identifikuar inspektorët me cilësi të lartë profesionale;
  - ç) të nxjerrë në pah aftësinë etiko-profesionale të inspektorëve në funksion të zhvillimit të detyrave;
  - d) të identifikojë nevojat për trajnim vazhdues të inspektorëve, në shërbim të rritjes së profesionalizmit të tyre dhe përshtatjes me zhvillimet ligjore dhe doktrinare;
  - dh) të nxisë përmirësimin e cilësisë dhe të sasisë së punës së inspektorëve dhe të krijojë standarde të qëndrueshme të punës pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
  - e) të përmirësojë marrëdhëniet e ndërveprimit hierarkik, duke saktësuar të drejtat dhe detyrat reciproke në funksion të orientimit të veprimtarisë së inspektorëve si një veprimtari profesionale të bazuar në ligj;

ë) të identifikojë problematikat aktuale gjatë ushtrimit të detyrës së inspektorëve me qëllim marrjen e masave për rritjen e efikasitetit dhe profesionalizmit të inspektorëve në përmbushje të përgjegjësive dhe detyrave të përcaktuara nga ligji.

#### Neni 4

### **Komponentët e vlerësimit të përformancës**

1. Vlerësimi i përformancës së inspektorëve kryhet duke analizuar secilin prej komponentëve që janë:

- a) Vlerësimi etik; dhe
- b) Vlerësimi profesional.

2. Vlerësimi etik konsideron edhe numrin e kërkesave për përjashtimin e inspektorëve nga shqyrtimi i çështjes për problematika të lidhura me konfliktin e interesit, por pa u kufizuar në to.

3. Vlerësimi profesional përfshin aftësitë profesionale në drejtim të analizës, arsyetimit ligjor dhe njohurive ligjore, qartësisë dhe saktësisë së praktikave të përzgjedhura nga shorti dhe që i përkasin periudhës për të cilën kryhet vlerësimi i punës.

4. Të gjitha të dhënat, dokumentet, praktikat dhe të tjera të lidhura me vlerësimin e secilit komponent të vlerësimit të performancës, përbëjnë dokumentacionin e vlerësimit, të cilat do të përfshihen në dosjen e vlerësimit.

#### Neni 5

### **Parimet e vlerësimit**

1. Sistemi i vlerësimit bazohet dhe zbatohet nëpërmjet këtyre parimeve:

a) parimi i pavarësisë, sipas të cilit procesi i vlerësimit nuk duhet të ndërhyjë në pavarësinë e zbatimit të detyrave nga inspektorët;

b) parimi i efikasitetit, sipas të cilit vlerësimi i zbatimit të detyrave kryhet nëpërmjet një procesi të shpejtë, me anë të procedurave të thjeshta dhe në afate kohore të arsyeshme;

c) parimi i konfidencialitetit, sipas të cilit anëtarët e KEV të ngarkuar me detyrën e vlerësimit, ruajnë konfidencialitetin e të dhënave të inspektorëve që vlerësohen, si dhe të dhënat e tyre personale, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) parimi i procesit të rregullt ligjor, sipas të cilit në procedurën e vlerësimit respektohen standardet e procesit të rregullt ligjor për inspektorët, duke përfshirë të drejtën për t'u njohur me aktet, të drejtën e aksesit në dosjen e vlerësimit, të drejtën për të marrë pjesë në proces, të drejtën e kontradiktoritetit, të drejtën për t'u dëgjuar, të drejtën për t'u mbrojtur, të drejtën për të pasur një akt vlerësimi të arsyetuar dhe të drejtën për t'u ankuar mbi aktin e vlerësimit.

#### Neni 6

### **Subjektet e vlerësimit**

1. Të gjithë inspektorët, me përjashtim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, janë subjekt i vlerësimit të tyre etiko-profesional, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë vendim.

2. Vlerësimi i bërë gjatë periudhës që inspektorët magjistratë, janë komanduar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, bëhet pjesë e vlerësimit të magjistratëve edhe për qëllimet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

## KREU II KRITERET, BURIMET DHE NIVELET E VLERËSIMIT

### Neni 7

#### **Kriteret dhe Niveli i Vlerësimit**

1. Vlerësimi etiko-profesional kryhet sipas kriterëve të grupuara si më poshtë:
  - a) aftësitë profesionale tek të cilat vlerësohen me radhë të gjithë komponentët mbi njohuritë ligjore dhe arsyetimin ligjor;
  - b) aftësitë organizative në përballimin e ngarkesës së punës;
  - c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, në të cilën bëjnë pjesë numri i kërkesave të pranuar për zëvendësim, të kërkuara nga magjistratët vendimmarrja e të cilëve është objekt i verifikimit, hetimit disiplinor ose inspektimit, por pa u kufizuar në to;
  - ç) aftësitë personale në angazhimin profesional.
2. Nivelet e vlerësimit për secilin nga kriteret e vlerësimit, përcaktohen mbi bazën e një shkalle pikëzimi nga 1 deri në 100.
3. Vlerësimi etiko-profesional i inspektorëve kryhet sipas “Metodologjisë së Vlerësimit” të parashikuar në Aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

### Neni 8

#### **Aftësitë profesionale**

1. Me anë të kriterit të aftësisë profesionale, vlerësohet aftësia e inspektorëve në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor.
2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e inspektorëve për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë të së drejtës dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën:
  - a) gjatë arsytimeve të projektvendimeve, relacioneve ose raporteve të hetimit disiplinor, bazohet në treguesit që referojnë në aftësinë e tij, për të përshkruar rrethanat faktike dhe ligjin e zbatueshëm, burimin dhe analizën e provave, analizën dhe konkluzionet sipas standardeve të unifikuara;

b) gjatë verifikimit, hetimit dhe ndërmarrjes së veprimeve, me qëllim ndërtimin e hetimit në përputhje me kërkesat ligjore dhe mbledhjen e provave të domosdoshme dhe të kërkuara nga ligji si dhe;

c) gjatë kryerjes së inspektimeve.

3. Aspekti i arsytimit ligjor të inspektorëve vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si:

a) saktësia, qartësia dhe kuptueshmëria e projektvendimeve, relacioneve ose raporteve. Në matjen e kësaj aftësie konsiderohet edhe shpeshtësia e kthimit të projektvendimit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe saktësia e përmbushjes së plotësimeve dhe korigjimeve të kërkuara;

b) struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e arsytimit;

c) aftësia për të marrë në pyetje magistratin për të cilin kryhet hetimi disiplinor;

ç) cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik.

## Neni 9

### **Aftësitë organizative**

1. Me anë të kriterit të aftësisë organizative vlerësohet aftësia e inspektorëve për të përballuar ngarkesën e punës, për të kryer me efektivitet procedurat e verifikimit, të hetimit disiplinor ose inspektimit si dhe aftësia për të administruar dosjet e detyrave të ngarkuara.

2. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës, matet duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore dhe plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo detyre, në rendimentin e përfundimit të detyrës dhe kohën mesatare për përmbylljen e procesit të hartimit dhe arsytimit të akteve që janë detyrë e inspektorëve.

3. Aftësia për të kryer me efektivitet procedurat e verifikimit, të hetimit disiplinor ose inspektimit matet duke u bazuar në aftësinë e inspektorëve për kryerjen e veprimeve hetimore dhe procedurale brenda afateve ligjore dhe dërgimin pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit.

4. Aftësia për të administruar dosjet e detyrave të ngarkuara matet duke u bazuar në treguesit e rregullshmërisë, plotësisë dhe saktësisë së dokumentacionit të dosjes.

## Neni 10

### **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

1. Me anë të kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale vlerësohet aftësia e inspektorëve për etikën në punë, integritetin dhe paanësinë.

2. Etika në punë në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion matet duke u bazuar në treguesit e dalë nga burimet e vlerësimit të tilla, si: rezultati i ankesave mbi punën e inspektorëve dhe verifikimi i tyre, mendimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë lidhur

me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion dhe vendime përfundimtare për masat disiplinore ndaj tij brenda periudhës përkatëse të vlerësimit.

3. Integriteti vlerësohet në raport me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm, matet duke u bazuar në tregues të tillë, si: rezultati i ankesave mbi punën e inspektorit dhe verifikimi i tyre, mendimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vendime përfundimtare për masat disiplinore ndaj tij brenda periudhës përkatëse të vlerësimit dhe/ose raportet e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

4. Paanësia vlerësohet në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit, duke u bazuar në tregues të tillë, si: përdorimi i gjuhës diskriminuese, numri i kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e inspektorëve nga shqyrtimi i çështjes, si dhe tregues të tjerë që dalin nga burime të tjera vlerësimi.

#### Neni 11

### **Aftësitë personale në angazhimin profesional**

1. Me anë të kriterit të aftësisë personale në angazhimin profesional, vlerësohen aftësitë e komunikimit, aftësia për të bashkëpunuar me kolegët dhe gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

2. Aftësia e komunikimit matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit të qartë dhe transparent me palët, publikun, subjektet e tjera, të tretët, në respektim të parimit të konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave personale.

3. Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit dhe bashkëveprimit me kolegët apo administratën e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe shkëmbimit të njohurive apo të përvojës profesionale me ta.

4. Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera matet duke u bazuar në tregues të tillë, si: pjesëmarrja në trajnime të tjera profesionale, disponueshmëria e inspektorëve për të udhëhequr dhe/ose trajnuar inspektorët e rinj, pjesëmarrja në grupet e punës dhe në hartimin e akteve nënligjore dhe rregulloreve të ILD-së, pjesëmarrja në veprimtari ndërinstytucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe publikimet ligjore akademike.

#### Neni 12

### **Burimet e vlerësimit**

1. Vlerësimi i inspektorëve bazohet në këto burime:

a) dosja personale e inspektorit;

b) të dhëna statistikore, të cilat përmbajnë për çdo inspektor:

i. të dhëna mbi volumin e përgjithshëm të punës në raport me numrin e përgjithshëm të inspektorëve, sipas organikës së miratuar;

- ii. numrin e projektvendimeve të hartuara prej tij apo në hartimin e të cilave ai ka marrë pjesë;
  - iii. numrin e ankesave të trajtuara brenda dhe jashtë afateve standarde të përcaktuara;
  - iv. të dhëna mbi etikën dhe disiplinën formale në punë për periudhën e vlerësimit;
  - v. çdo e dhënë që tregon zhvillimin profesional të inspektorit;
  - vi. detyrat e tjera që i janë ngarkuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
- c) dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim, sipas nenit 27 të këtij vendimi;
- ç) vlerësimi i kryer nga vetë inspektori dhe vendimet ose aktet e hartuara dhe të përzgjedhura prej tij, që në çdo rast nuk duhet të jetë më shumë se dy në vit;
- d) mendimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- dh) të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj inspektorit gjatë periudhës së vlerësimit;
- e) vendimet përfundimtare për masat disiplinore që janë dhënë gjatë periudhës së vlerësimit, në mënyrë të pavarur, nëse masa disiplinore është shuar ose jo;
- ë) raporte të kërkuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ose institucione të tjera audituese ose kontrolluese, në rastet kur çmohen të nevojshme;
- f) vlerësimi i jashtëzakonshëm sipas parashikimit të nenit 19 pika 3, të këtij vendimi;
- g) dokumente që vërtetojnë pjesëmarrjen dhe përfshirjen e inspektorit në veprimtari trajnuese përfshirë informacione me shkrim nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera, e që vërtetojnë pjesëmarrjen ose përfshirjen e inspektorit në aktivitete trajnimi.

### Neni 13

#### **Tabela Statistikore**

1. Tabela statistikore, është baza e të dhënave statistikore sipas parashikimit të pikës 1, shkronja “b”, e nenit 12 të këtij vendimi.
2. Në tabelën statistikore, të dhënat regjistrohen dhe përditësohen duke kategorizuar llojin e detyrës sipas kategorive të parashikuara nga neni 214 i ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me qëllim lehtësimin e procedurës të përzgjedhjes së tyre me short sipas kategorive, në mënyrë që gjatë procesit të vlerësimit të sigurohet shqyrtimi i rasteve që përfaqësojnë secilin lloj, si dhe volumi dhe shpejtësia e kryerjes së detyrës.
3. Tabela statistikore është baza e të dhënave për vlerësimin e performancës profesionale.
4. Tabela statistikore do të hartohet dhe dorëzohet në Komision nga personeli administrativ i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
5. Tabla statistikore përmban të paktën informacionin si vijon për secilën dosje të ngarkuar ndaj inspektorit nën vlerësim:

- a) numrin e protokollit të ankesës së caktuar inspektorit;
- b) datën e marrjes në dorëzim të ankesës nga ana e ILD;
- c) emrin dhe funksionin e ankuesit;
- ç) emrin dhe funksionin e magjistratit ndaj të cilit është ngritur ankesa;
- d) datën se kur kjo çështje iu ngarkua inspektorit;
- dh) datën dhe llojin e projekt vendimit (mbi arkivimin ose mbi verifikimin);
- e) datën e arkivimit të ankesës (pas shqyrtimit fillestar ose pas verifikimit);
- ë) datën e fillimit të hetimit disiplinor dhe të dhënat mbi shkeljen disiplinore;
- f) datën e pezullimit të hetimit disiplinor nëse ka pasur dhe të dhëna rreth llojit të pezullimit;
- g) datën e zgjatjes së afatit të hetimit disiplinor, nëse ka pasur dhe periudhën e kësaj zgjatjeje;
- gj) projekt vendimin e inspektorit në përfundim të hetimit disiplinor, datën dhe propozimet e dhëna.
- h) vendimi i ILD (numri, data dhe një përshkrim i shkurtër) për:
  - i. arkivimin pas shqyrtimit fillestar;
  - ii. verifikimin;
  - iii. arkivimin pas verifikimit;
  - iv. fillimin e hetimit disiplinor;
  - v. pezullimin e hetimit disiplinor;
  - vi. mbylljen e hetimit disiplinor;
  - vii. fillimin e procedimit disiplinor.
- i) apelimet kundër vendimeve të ILD (data e apelimit, ankuesi dhe organin kompetent: KLGJ, KLP, Gjykatat);
- j) vendimet bazuar në apelimet;
- k) ndonjë akt tjetër i rëndësishëm lidhur me ankuesin.

#### Neni 14

#### **Kategorizimi i praktikave në tabelën statistikore**

1. Përveç të dhënave statistikore sipas parashikimeve të pikës 1, shkronja “b”, e nenit 12 dhe pikës 5, të nenit 13 të këtij vendimi, në tabelën statistikore praktikat kategorizohen sipas llojit të detyrës përkatësisht:

- a) Arkivim;
- b) Verifikim;
- c) Hetim disiplinor; ose
- ç) Inspektim.

2. Secila kategori duhet të identifikohet në sistem edhe me të dhënat për natyrën e çështjes për të cilën nisat verifikimi, hetimi disiplinor ose inspektimi, përkatësisht:

- a) Civile;



- b) Penale; ose
- c) Administrative.

#### Neni 15

#### **Nivelet e vlerësimit**

1. Vlerësimi kryhet sipas këtyre niveleve:

- a) “Shkëlqyeshëm”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi shumë të larta;
- b) “Shumë mirë”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mbi mesataren;
- c) “Mirë”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mesatare;
- ç) “Mjaftueshëm”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi nën mesataren;
- d) “I pamjaftueshëm”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi të dobët;

2. Vlerësimi i përgjithshëm “shkëlqyeshëm” jepet në ato raste kur inspektori është vlerësuar “shkëlqyeshëm” për të katërta kriteret.

3. Vlerësimi i përgjithshëm “shumë mirë” jepet në ato raste kur inspektori vlerësohet “shumë mirë” për tri kriteret dhe “mirë” për njërin prej tyre. Në çdo rast, kriteret “aftësitë profesionale” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” duhet të jenë vlerësuar “shumë mirë”.

4. Vlerësimi i përgjithshëm “mirë” jepet në rastin kur aftësitë e inspektorit vlerësohen “mirë” për dy kriteret dhe “mjaftueshëm” për dy kriteret e tjera. I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin kur ka barazi në vlerësimin e kriterëve në nivelet “mjaftueshëm” dhe “i pamjaftueshëm”, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në pikën 3, të këtij neni. Në çdo rast, kriteri “etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” duhet të vlerësohet të paktën “shumë mirë”.

5. Vlerësimi i përgjithshëm “i pamjaftueshëm” jepet në këto raste:

- a) kur inspektori vlerësohet “i pamjaftueshëm” për të paktën në tre kriteret;
- b) kur inspektori vlerësohet “i pamjaftueshëm” për kriteret “aftësitë profesionale” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” dhe jo më shumë se “mirë” për dy kriteret e tjera.

#### Neni 16

#### **Periudha e vlerësimit**

1. Çdo inspektor, vlerësohet 1 herë në dy vjet dhe periudha e vlerësimit etiko-profesional i referohet periudhës 2 vjeçare të punës së inspektorit. Periudha 2-vjeçare llogaritet në vite kalendarike.

2. Periudha 2 vjeçare për inspektorin që i nënshtrohet vlerësimit për herë të parë, llogaritet nga data e emërimit në detyrë ose komandimit, në rastin e inspektorëve magjistratë, deri në përfundimin e vitit të dytë kalendarik në të cilin ushtron funksionin e inspektorit.

#### Neni 17

### **Hartimi i Projekt - Programit Vjetor të Vlerësimit**

1. KEV, brenda muajit tetor të çdo viti shqyrton projekt - programin e vlerësimit për vitin e ardhshëm dhe njofton inspektorët të cilët i nënshtrohen vlerësimit në vitin e ardhshëm.
2. Në përgatitjen e projektprogramit, KEV mbështetet nga administrata e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përputhje me Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Zyrës së ILD-së.
3. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, brenda muajit shtator përgatit listën nominale të inspektorëve që do i nënshtrohen vlerësimit etiko - profesional në vitin pasardhës. Lista përmban të dhëna mbi:
  - a) periudhën e ushtrimit të funksionit si inspektor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
  - b) periudhën më të fundit të vlerësimit për inspektorin.
4. Projekt - Programi i vihet në dispozicion KEV dhe plotësohet me çdo të dhënë tjetër që KEV i konsideron të nevojshme për hartimin e tij.

#### Neni 18

### **Miratimi i Programit Vjetor të Vlerësimit**

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë me propozim të KEV, brenda muajit nëntor të çdo viti, miraton programin vjetor të vlerësimeve etiko - profesionale të inspektorëve.
2. Programi vjetor përmban planifikimin tremujor të vlerësimeve individuale, duke siguruar një organizim funksional të procedurave të vlerësimit dhe afateve të shqyrtimit dhe vendimmarjes nga KEV.
3. Vendimi për miratimin e programit të vlerësimit etik dhe profesional të inspektorëve publikohet në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

#### Neni 19

### **Llojet e Vlerësimit**

1. Vlerësimet etike - profesionale, janë të zakonshme dhe të jashtëzakonshme;
2. Vlerësimi i zakonshëm është ai që kryhet sipas nenit 16 të këtij vendimi;
3. Vlerësimi i jashtëzakonshëm është vlerësimi që bëhet me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ose me kërkesë të vetë inspektorit;
4. Vlerësimi i jashtëzakonshëm dokumentohet me shkrim dhe bëhet pjesë e dosjes personale të inspektorit të parashikuar nga neni 12, pika 1, shkronja "a" e të këtij vendimi.

#### Neni 20

### **Vlerësimi me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë**

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, mund të kërkojë vlerësimin e jashtëzakonshëm me procedurë të përshpejtuar të inspektorit:

- a) për secilin nga shkaqet e përmendura në pikën 1, të nenit 21 të këtij vendimi;
- b) për shkak të lirimit nga detyra jo me kërkesë të inspektorit; ose
- b) për arsye të tjera të cilat nuk mund të presin vlerësimin e radhës e që duhet të justifikohen në kërkesë.

2. Vlerësimi i jashtëzakonshëm për raste të tjera, të specifikuara në kërkesë, mund të bëhet për secilin nga komponentën e vlerësimit, ose për të dy bashkë.

3. Vlerësimi i jashtëzakonshëm që nuk lidhet me largimin e inspektorit nga funksioni, bëhet pjesë e vlerësimit vjetor të inspektorit.

#### Neni 21

#### **Vlerësimi i jashtëzakonshëm me kërkesë të inspektorit**

1. Inspektori vlerësohet me procedurë të përshpejtuar sipas kërkesës së tij me shkrim në rastet e mëposhtme:

- a) kërkon të lirohet nga detyra e inspektorit jo magjistrat;
- b) kërkon të transferohet apo ngrihet në detyrë brenda sistemit të drejtësisë për inspektorin magjistrat;
- c) në përfundim të periudhës së komandimit për inspektorin magjistrat.

2. Vlerësimi i jashtëzakonshëm me kërkesë të vetë inspektorit, bëhet për periudhën e mbetur nga vlerësimi më i fundit.

#### Neni 22

#### **Afatet e vlerësimit të jashtëzakonshëm**

1. Afatet e kryerjes së vlerësimit të jashtëzakonshëm janë në vartësi të kohës kur duhet dorëzuar vlerësimi dhe arsyetohen në kërkesën për vlerësimin e jashtëzakonshëm.

2. KEV, në vartësi të afateve dhe çështjeve të parashtruara në kërkesë për vlerësimin sipas kësaj procedure, përzgjedh me short jo më shumë se tre praktika detyrash të përmbyllura të inspektorit, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 28 të këtij vendimi.

3. Për vlerësimin e jashtëzakonshëm, vlejné rregullat procedurale të vlerësimit të zakonshëm.

### KREU IV

### **PËRGATITJA E PROCESIT TË VLERËSIMIT**

Neni 23  
**Fazat e vlerësimit**

Vlerësimi etiko - profesional bëhet sipas fazave vijuese:

- a) veprimet paraprake të cilat përfshijnë hartimin, miratimin dhe publikimin e programit vjetor të vlerësimit, ngritjen e KEV për vitin përkatës;
- b) mbledhja e dokumentacionit të vlerësimit, caktimi i relatorit përgjegjës për secilin vlerësim, ngritja e sekretariatit teknik dhe krijimi i dosjes së vlerësimit nga relatori;
- c) hartimi i projektraportit të vlerësimit nga relatori;
- ç) rishikimi i përfundimit të procedurave të vlerësimit nga KEV;
- d) miratimi i projektraportit të vlerësimit nga KEV.

Neni 24  
**Mbledhja e dokumentacionit të vlerësimit**

1. Dokumentacioni e vlerësimit është dosja e hapur për çdo inspektor që përmban gjithë dokumentacionin përkatës të referuar në burimet e vlerësimit.

2. Brenda dy javëve të para të muajit janar kryhet mbledhja e dokumentacionit të vlerësimit për secilin inspektor që i nënshtrohet vlerësimit sipas programit të miratuar të vlerësimit për vitin përkatës. Dokumentacioni i vlerësimit përmban:

- a) aktet e vlerësimit të dërguara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
- b) përmbledhje e të dhënave statistikore në lidhje me:
  - i) numrin e detyrave të kryera duke detajuar ankesat e arkivuara, të verifikuara, për të cilat është filluar një hetim disiplinor, ose për të cilat është mbyllur hetimi disiplinor apo ka përfunduar hetimi dhe i janë dërguar për procedim disiplinor Këshillave përkatës gjatë periudhës për të cilën bëhet vlerësimi. Këto të dhëna kategorizohen sipas natyrës së çështjeve;
  - ii) kohën e shqyrtimit të detyrave duke e krahasuar me afatin standard minimal dhe numrin e çështjeve të shqyrtuara përtej atij afati;
  - iii) të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj inspektorit gjatë periudhës së vlerësimit, si dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore të dhëna ndaj inspektorit, të cilat zbatohen gjatë periudhës së vlerësimit ose raporte të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;
- c) numrin e çështjeve, në të cilat inspektori është përjashtuar për shkak të konfliktit të interesit, me kërkesë të palëve;
- d) të dhënat e tjera statistikore të caktuara nga Komisioni.

3. Përmbajtja e dokumentacionit të vlerësimit listohet në një raport, në të cilin të dhënat analizohen në mënyrë të detajuar dhe të strukturuar.

4. Në çdo kohë inspektori ka të drejtë të ketë akses në dosjen e tij të vlerësimit dhe të marrë kopje të akteve apo ekstrakte të tyre.

5. Afati standard minimal, sipas pikës 2 të këtij neni, përcaktohet mbi bazën e një mesatareje të nxjerrë nga analiza e detyrave të kategorizuara në atë natyrë çështjeje.

#### Neni 25

##### **Caktimi dhe zëvendësimi i relatorit**

1. Bazuar në listën e inspektorëve që i nënshtrohen vlerësimit, në bazë të programit të miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, KEV cakton me short relatorin përgjegjës për secilin vlerësim, duke marrë parasysh shpërndarjen e barabartë të numrit të inspektorëve që vlerësohen.

2. Anëtarët zëvendësues përfshihen në short për zgjedhjen e relatorit.

3. Relatori përgjegjës për vlerësimin mund të zëvendësohet nëse ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit duke parashtruar pengesat ligjore që e bëjnë të pamundur ndjekjen e rastit objekt vlerësimi.

4. Në rastet e përcaktuara në pikën 3, kërkesa për zëvendësimin e relatorit për vlerësimin, i paraqitet KEV nga vetë relatori ose nga inspektori që vlerësohet.

5. KEV shqyrton kërkesën dhe nëse e pranon atë, kryen menjëherë procedurën e shortit për zëvendësimin e tij.

6. Procedurat e hedhjes së shortit për caktimin ose zëvendësimin e relatorit përcaktohen në Aneksin nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi.

#### Neni 26

##### **Roli i Administratës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përgatitjen e dokumentacionit**

1. KEV në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm lidhur me periudhën e vlerësimit, mbështetet nga administrata e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në përputhje me Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Zyrës së ILD. Për çdo çështje vlerësimi, Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së ILD cakton nëpunësin përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve tek relatori. Nëpunësi përgjegjës kryen vetëm detyra që kërkohen për vlerësimin që kryhet nën drejtimin relatorit.

2. Inspektori njoftohet me shkrim për relatorin dhe nëpunësin përgjegjës, të caktuar për vlerësimin e tij.

#### Neni 27

##### **Krijimi dhe përmbajtja e dosjes së vlerësimit**

1. Relatori përgjegjës për vlerësimin njofton inspektorin dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedurës së vlerësimit.

2. Brenda tre javëve nga marrja e njoftimit për fillimin e procedurës së vlerësimit, inspektori përgatit vetëvlerësimin, sipas formularit të Aneksit nr.2 bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Brenda dy muajve nga marrja e njoftimit të relatorit, Inspektori i Lartë të Drejtësisë jep mendim sipas kritereve të vlerësimit.

4. Bazuar në të dhënat statistikore, me qëllim përzgjedhjen e akteve objekt vlerësimi, relatori përcakton datën e hedhjes së shortit për përzgjedhjen e çështjeve/praktikave të përfunduara nga numri i përgjithshëm i detyrave të përfunduara nga secili inspektor.

5. Shorti zhvillohet me praninë e anëtarëve të KEV dhe përzgjedh në mënyrë proporcionale në varësi të numrit të detyrave për secilën kategori sipas parashikimit të nenit 14 të këtij vendimi.

6. Relatori brenda dy javësh nga paraqitja e dokumentacionit të vlerësimit, krijon dosjen e vlerësimit, në të cilën përfshihen burimet e tjera të vlerësimit sipas nenin 12 të këtij vendimi.

7. Shorti zhvillohet në përputhje me nenin 28, pika 4 të këtij vendimi dhe referohet në një procesverbal të nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm, i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe nga anëtarët e KEV.

#### Neni 28

##### **Përzgjedhja e çështjeve për vlerësim (shorti)**

1. Për vlerësimin etik dhe profesional të veprimtarisë së inspektorit përzgjidhen me short jo më shumë se katër detyra të përfunduara nga inspektori në periudhën për të cilën bëhet vlerësimi. Procedurat e shortit për përzgjedhjen e çështjeve për vlerësim, bëhen sipas Aneksit nr. 5 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në short përfshihen të gjitha dosjet e detyrave të kryera.

3. Përzgjedhja me short realizohet pas fillimit të procedurës së vlerësimit dhe konsiderohet pjesë e kësaj procedure, pavarësisht nga veprime të tjera.

4. Shorti zhvillohet nën mbikëqyrjen e të gjithë anëtarëve të Komisionit të Emërimit dhe Vlerësimit. Nëse është e mundur, shorti realizohet në mënyrë elektronike nga administrata e Zyrës së ILD.

#### Neni 29

##### **Vlerësimi i kryer nga vetë inspektori (vetëvlerësimi)**

1. Inspektori kryen vlerësimin etik dhe profesional të punës së tij, nëpërmjet të cilit:

- a) vlerëson aktivitetin përkundrejt kritereve vlerësuese;
- b) paraqet një analizë të të dhënave statistikore që lidhen me veprimtarinë e tij si inspektor;

c) përshkruan masat që ka ndërmarrë për përmbushjen e objektivave të përcaktuar në vlerësimin e mëparshëm;

ç) përshkruan shkallën në të cilën janë përmbushur këto objektiva, duke dhënë edhe shpjegimin përkatës;

d) përshkruan objektivat për zhvillimin e tij profesional për vlerësimin e ardhshëm të tij;

dh) përshkruan nevojat për trajnim dhe rrethanat, të cilat përbëjnë pengesë për zhvillimin e tij profesional dhe propozon zgjidhje konkrete për periudhën e ardhshme të vlerësimit.

2. Vlerësimi shoqërohet me jo më shumë se 2 akte (projektvendime/relacione/raporte) të hartuara prej inspektorit, të përzgjedhura prej tij, të cilat duhet të sigurojnë një përfaqësim të plotë të llojit të tyre sipas parashikimeve të nenit 14 të këtij vendimi, si dhe me informacione nga institucione të tjera sipas parashikimeve të nenit 31 të këtij vendimi.

#### Neni 30

### **Mendimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë**

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë paraqet mendim për veprimtarinë e inspektorit, në të cilin përshkruan veprimtarinë e inspektorit dhe vlerësimin e tij për këtë veprimtari, sipas kritereve të vlerësimit, duke u bazuar në nivelet e vlerësimit të parashikuara në këtë vendim, duke u ndalur veçanërisht në ato kritere për të cilat mendimi ndryshon nga vlerësimi i kryer nga vetë inspektori. Gjithashtu, në mendimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pasqyrohet analiza e të dhënave statistikore të veprimtarisë së inspektorit, e cila hartohet në përputhje me metodologjinë e parashikuar në Aneksin nr. 1 të këtij vendimi.

2. Mendimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i njoftohet inspektorit brenda katër javëve nga data e marrjes së njoftimit nga Komisioni i Emërimit dhe Vlerësimit.

3. Brenda tre ditëve nga njoftimi i mendimit, inspektori gëzon të drejtën për t'u dëgjuar dhe paraqet kërkesë për zhvillimin e një takimi me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvillon takimin me inspektorin brenda dy javëve nga data e depozitimit të kërkesës dhe merr masat për pasqyrimin e takimit në procesverbal, i cili i bashkëlidhet mendimit dhe jo më vonë se një muaj nga data e njoftimit nga Komisioni i Emërimit dhe Vlerësimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë paraqet mendimin përfundimtar për veprimtarinë e inspektorit, i cili pasqyron edhe kundërshtimet e mundshme të inspektorit.

#### Neni 31

### **Informacioni nga institucione të tjera**

1. Relatori mbledh dhe përfshin në dosjen e vlerësimit:

a) informacionin e marrë nga Shkolla e Magjistraturës lidhur me pjesëmarrjen në formimin vazhdues për inspektorët magjistrat. Informacioni kërkohet për numrin e trajnimeve në të cilat magjistrati është ftuar, temën dhe kohëzgjatjen e trajnimeve, nivelin e pjesëmarrjes së magjistratit dhe nëse është e mundur edhe nivelin e aktivizimit;

b) informacionin e marrë nga Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit lidhur me saktësinë dhe korrektësinë e deklarimit të pasurisë për periudhën e vlerësimit në rastet kur është çmuar e nevojshme të merren.

c) informacionin e marrë nga institucione të tjera sipas parashikimeve të nenit 12, pika 1, shkronja “ë” të këtij vendimi, në rastet kur është çmuar e nevojshme të merren.

2. Shkolla e Magjistraturës, në cilësinë e institucionit përgjegjës për formimin vazhdues të magjistratit, dokumenton pjesëmarrjen e inspektorit magjistrat në formimin vazhdues.

## KREU VI

### SHQYRTIMI I DOSJES SË VLERËSIMIT DHE MARRJA E VENDIMIT

#### Neni 32

#### **Hartimi i projektraportit të vlerësimit**

1. Brenda dy javëve nga krijimi i dosjes së vlerësimit, relatori përgjegjës për vlerësimin harton projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional në përputhje me Aneksin nr. 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Projektraporti i vlerësimit përmban:

a) listën e dokumenteve të dosjes së vlerësimit dhe analizon në mënyrë të detajuar dhe të strukturuar veprimet në dosjen e vlerësimit;

b) të dhënat e marra nga burimet e vlerësimit dhe analiza e tyre për vlerësimin e veprimtarisë së inspektorit sipas kriterëve të vlerësimit;

c) analizën e të dhënave statistikore për rendimentin e përfundimit të detyrave, kohëzgjatjen dhe kohën mesatare të arsytimit të projektvendimeve ose të përfundimit të detyrave;

c) propozimin për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit;

ç) propozimin për trajnime ose rekomandime për hapat që duhen ndërmarrë për të përmirësuar veprimtarinë e inspektorit.

3. Analiza e të dhënave statistikore për rendimentin e përfundimit të shqyrtimit fillestar/verifikimit/hetimit disiplinor të ankesave, kohëzgjatjen e shqyrtimit/verifikimit/hetimit disiplinor, kohën mesatare të arsytimit të projektvendimeve/relacioneve/raporteve bazohet në kompleksitetin e ankesës, volumin e dosjeve, rritjen e papritur të volumit të dosjeve dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës.

4. Projektraporti i vlerësimit shoqërohet me raportin që përshkruan dhe analizon në mënyrë të detajuar të dhënat e mbledhura.

5. Projektraporti i vlerësimit është pjesë përbërëse e dosjes së vlerësimit.

#### Neni 33



## **Vënia në dispozicion të inspektorit e projektraportit të vlerësimit**

1. Projektraporti i hartuar nga relatori i njoftohet inspektorit objekt vlerësimi, i cili ka të drejtën e njohjes me dosjen e vlerësimit dhe të drejtën për të paraqitur kundërshtime me shkrim brenda një jave nga data e marrjes së njoftimit për hartimin e projektraportit. Njohja e inspektorit me dosjen e vlerësimit dokumentohet me shkrim.

2. Inspektori ka të drejtë të dëgjohet nga KEV në mbledhjen e planifikuar, gjatë të cilës do të shqyrtohet projektraporti i vlerësimit. Shpjegimet e paraqitura me shkrim nga inspektori nuk përsëriten gjatë seancës dëgjimore.

### **Neni 34**

#### **Shqyrtimi i projektraportit të vlerësimit**

1. Relatori i përcjell për shqyrtim, KEV projektraportin e vlerësimit etiko-profesional të inspektorit.

2. Nëse inspektori nuk ka kërkuar të dëgjohet nga KEV, çështja shqyrtohet në bazë të projektraportit të përgatitur nga relatori, i cili përgjigjet për çdo pyetje të ngritur nga anëtarët e KEV.

3. Nëse inspektori ka kërkuar të dëgjohet, çështja shqyrtohet në bazë të projektraportit të përgatitur nga relatori dhe shpjegimeve të inspektorit, të cilat i ka paraqitur paraprakisht me shkrim.

4. Çdo anëtar i KEV ka të drejtë t'i bëjë pyetje inspektorit dhe me kërkesë të inspektorit, ose për shkak të nevojës për sqarimin e fakteve, KEV mund të thërrasë edhe persona të tjerë në seancën dëgjimore.

5. Nëse gjatë shqyrtimit të vlerësimit konstatohen gabime procedurale, ose materiale, ose nëse nevojiten prova të tjera që mund të ndikojnë në nivelin e vlerësimit dhe korrigjimi i këtyre gabimeve nuk mund të bëhet menjëherë për shkak të nevojës për të marrë dokumente të tjera, KEV mund të urdhërojë shtyrjen e mbledhjes për jo më shumë se një javë.

6. KEV, pasi shqyrton projektraportin e vlerësimit, bazuar në diskutimet e mbledhjes, vendos të miratojë të pandryshuar projektraportin, të miratojë me ndryshime ose të kërkojë hartimin e një projektraporti të ri të vlerësimit nga anëtari relator. Në rastet kur KEV vendos të kërkojë hartimin e një projektraporti të ri, projektraporti i ri i vlerësimit hartohet brenda dy javëve nga marrja e vendimit të KEV dhe shqyrtohet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 33 të këtij vendimi.

### **Neni 35**

#### **Miratimi i raportit përfundimtar**

1. Në përfundim të procesit të shqyrtimit të projektraportit, komisioni miraton me shumicë votash “Nivelin e Vlerësimit Etiko-Profesional” të inspektorit për periudhën përkatëse. Raporti i vlerësimit që miratohet nga KEV është pjesë përbërëse e vendimit.

2. Vendimi i KEV është pjesë përbërëse e dosjes personale të inspektorit të vlerësuar, e cila administrohet dhe ruhet në përputhje me Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

3. Në rastet kur KEV vlerëson inspektorin me një nivel të ndryshëm ose bën një arsyetim të ndryshëm nga ai i propozuar në projektraportin e vlerësimit, atëherë në vendim pasqyrohen arsyet përkatëse.

5. Në rastin kur inspektori magjistrat vlerësohet “i pamjaftueshëm”, vepohet në përputhje me pikën 5, të nenit 95 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### Neni 36

### **Përfundimi i vlerësimit pa raport përfundimtar**

1. Procedura e vlerësimit etik dhe profesional e filluar ndaj inspektorit magjistrat deklarohet si e përfunduar pa një vendim përfundimtar, kur inspektori ndodhet në kushtet e mbarimit të statusit, sipas rasteve të parashikuara në nenin 64 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Procedura e vlerësimit etik dhe profesional e filluar ndaj inspektorit jomagjistrat deklarohet për shkak të rrethanave, si e përfunduar pa një vendim përfundimtar.

#### Neni 37

### **Ankimi i inspektorit**

1. Inspektori ka të drejtë të ankimojë vendimin e vlerësimit të KEV, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, vetëm për shkelje të rënda procedurale.

2. KEV publikon ekstrakte të raportit të vlerësimit dhe të vendimit, duke respektuar të drejtën e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të inspektorit.

#### Neni 38

### **Transparenca e vendimmarrjes së KEV**

1. Çdo vit kalendarik KEV harton raportin për veprimtarinë e vlerësimit të inspektorëve të kryer në vitin paraardhës.

2. Raporti për veprimtarinë e vlerësimit publikohet në faqen e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në fund të muajit mars të vitit pasardhës.

3. Çdo tre vjet, brenda muajit mars të vitit përkatës, Zyra e ILD publikon një raport periodik për sistemin e vlerësimit.

## KREU VII KOMISIONI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT (KEV)

Neni 39

### **Përbërja e KEV**

1. KEV organizohet si organi kolegjal dhe anëtarët e KEV, si dhe anëtarët zëvendësues zgjidhen sipas kërkesave dhe procedurave të parashikuara në pikën 1, të nenit 212, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

2. Në raste të pamundësisë, në rast të konfliktit të interesit, ose pengesave ligjore, anëtari i KEV zëvendësohet nga anëtari zëvendësues.

3. Shorti për ngritjen e KEV për vitin pasardhës, hidhet një herë në vit, brenda muajit dhjetor të çdo viti kalendarik, në përputhje me Aneksin nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 40

### **Vendimmarrja e KEV**

1. KEV e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë kolegjinale në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kre, të cilat plotësohen për aq sa është e mundur nga rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjinale.

2. KEV në ushtrimin e funksioneve të tij, ndihmohet nga një sekretariat teknik. Struktura përkatëse në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që do të kryejë rolin e sekretariatit teknik dhe detyrat e saj, përcaktohen me urdhër të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

3. Anëtarët e Komisionit për shqyrtimin, diskutimin dhe vendimmarrjen në lidhje me dosjen e vlerësimit, projektraportin e vlerësimit dhe raportin përfundimtar, organizojnë mbledhje sipas një kalendarit të hartuar nga relatori i dosjes së vlerësimit dhe të miratuara paraprakisht nga KEV.

4. Procedurat dhe vendimet e KEV do të jenë në përputhje me Ligjin, këtë Rregullore dhe Metodologjinë e Vlerësimit, e cila është Aneks i kësaj Rregulloreje.

5. Vendimet e Komisionit miratohen me shumicë të thjeshtë votash të tre anëtarëve.

6. Anëtari i Komisionit që ka votuar kundër shumicës referon me shkrim arsyetimin për votimin kundër vlerësimit, i cili përfshihet në raport si arsyetim i pakicës.

Neni 41

### **Konflikti i interesit të anëtarit të KEV**

Anëtari i KEV ose anëtari zëvendësues i cili është në dijeni të një situatë konflikti interesi ose pengesë ligjore për përgatitjen, shqyrtimin ose marrjen e një vendimi për dosjen e vlerësimit, është i detyruar të deklarojë natyrën e interesit ose të pengesës ligjore dhe të mos marrë pjesë në veprimtaritë dhe mbledhjet e KEV kur trajtohet dosja përkatëse.

#### Neni 42

##### **Detyrat e relatorit**

1. Relatori është përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të inspektorit dhe merr masat e mëposhtme:

a) i kërkon sekretariatit teknik njoftimin e inspektorit për fillimin e procedurës së vlerësimit dhe mbi të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit;

b) mbledh dokumentacionin e vlerësimit duke bashkëpunuar me stafin mbështetës të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe institucione të tjera;

c) i kërkon sekretariatit teknik njoftimin e anëtarëve të komisionit për krijimin e dosjes së vlerësimit dhe përgatitjen e projektraportit të vlerësimit;

ç) harton projektraportin e vlerësimit brenda afateve të përcaktuara në nenin 32 të këtij vendimi dhe në Programin Vjetor të Vlerësimit dhe ia paraqet anëtarëve të komisionit për shqyrtim dhe miratim bashkë me kalendarin për dosjen e posaçme të vlerësimit;

d) gjatë mbledhjeve sqaron anëtarët e tjerë të KEV dhe iu përgjigjet pyetjeve të tyre në lidhje me dosjen e vlerësimit si dhe projektraportin e vlerësimit;

2. Në kryerjen e funksioneve të tij, relatori mbështetet nga sekretariati teknik i cili përcaktohet me urdhër të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

#### Neni 43

##### **Përjashtimi dhe zëvendësimi i relatorit**

1. Në rastet kur inspektori që është subjekt i vlerësimit, ushtron të drejtën e tij për të kërkuar përjashtimin e relatorit, KEV mblidhet brenda 48 orëve për vlerësimin dhe vendimmarjen lidhur me kërkesën.

2. Në rastet kur KEV vlerëson të drejtë kërkesën, vendos zëvendësimin e relatorit nga anëtari zëvendësues, që ka rezultuar nga shorti i vitit gjatë të cilit e ushtron veprimtarinë KEV-i përkatës.

#### Neni 44

##### **Dispozitë tranzitore**

1. Për herë të parë KEV ngrihet në dhjetor 2022.

2. Përjashtimisht për periudhën e parë të vlerësimit, shorti i anëtarëve të komisionit hidhet vetëm për inspektorët që vijnë nga radhët e magjistratëve dhe që janë vlerësuar të paktën

“shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit etikoprofesionale si magjistratë nga këshillat përkatës dhe janë në detyrë në datë 1 dhjetor 2022.

3. Shorti për ngritjen e KEV hidhet në çdo rast përpara afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, në rastet e parashikuara në nenin 21 të këtij vendimi.

## ANEKSI nr. 1

### METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

1. Metodologjia e Vlerësimit ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të inspektorit për secilin kriter dhe treguesit përkatës ligjor, mbi bazën e një sistemi pikësh të përcaktuar mbi meritat e inspektorit, kualifikimin, integritetin, aftësinë dhe efikasitetin e tij, duke respektuar parimin e pavarësisë së inspektorit.
2. Për aq sa ligji e lejon, përcaktimi i treguesve shtesë të çdo kriteri vlerësues dhe pesha specifike e tyre bëhet në tabelën e pikëzimit, pjesë e kësaj metodologjie.
3. Vlerësimi i inspektorit kryhet sipas kriterëve të mëposhtme:
  - a. aftësitë profesionale të inspektorit;
  - b. aftësitë organizative;
  - c. etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale të inspektorit;
  - d. aftësitë personale dhe angazhimi profesional.
4. Vlerësimi i inspektorit kryhet sipas këtyre niveleve:
  - a. Vlerësimi i përgjithshëm “Shkëlqyeshëm” jepet në ato raste kur inspektori është vlerësuar “Shkëlqyeshëm” për të katërta kriteret.
  - b. Vlerësimi i përgjithshëm “Shumë mirë” jepet vetëm në ato raste kur inspektori vlerësohet “Shumë mirë” për tre kriteret dhe “Mirë” për njërin prej tyre. Në çdo rast, kriteret “aftësitë profesionale të inspektorit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” duhet të jenë vlerësuar “Shumë mirë”.
  - c. Vlerësimi i përgjithshëm “Mirë” jepet në rastin kur aftësitë e inspektorit vlerësohen “Mirë” për dy kriteret dhe “Mjaftueshëm” për dy kriteret e tjera. I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin kur ka barazi në vlerësimin e kriterëve në nivelet “Mjaftueshëm” dhe “I pamjaftueshëm”. Në çdo rast, kriteret “aftësitë gjyqësore” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” duhet të vlerësohen të paktën “Mirë”.
  - d. Vlerësimi i përgjithshëm “I pamjaftueshëm” jepet në këto raste:
    - kur inspektori vlerësohet “I pamjaftueshëm” për të paktën në 3 kriteret;
    - kur inspektori vlerësohet “I pamjaftueshëm” për kriteret “aftësitë profesionale të inspektorit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” dhe jo më shumë se “Mirë” për dy kriteret e tjera.

Për çdo kombinim tjetër të ndryshëm nga ato të parashikuar më lart, niveli i përgjithshëm i vlerësimit do të përcaktohet në varësi të mesatares së pikëve të katër kriterëve, sipas shkallës së pikëzimit të përcaktuar në pikën 9 të kësaj metodologjie.

7. Niveli i vlerësimit të inspektorit përcaktohet për çdonjërin nga katër kriteret e vlerësimit.
8. Niveli i vlerësimit për çdonjërin nga kriteret e vlerësimit, përcaktohet mbi bazën e një shkalle pikëzimi nga 1 deri në 100 pikë.
9. Shkalla e pikëzimit që përcakton nivelet e vlerësimit është:
  - a. 90 deri 100 pikë “Shkëlqyeshëm”;
  - b. 70 deri 89 pikë “Shumë mirë”;
  - c. 50 deri në 69 pikë “Mirë”;
  - d. 30 deri në 49 pikë “Mjaftueshëm”;
  - e. 1 deri në 29 pikë “Pamjaftueshëm”.

## **1. AFTËSIA PROFESIONALE E INSPEKTORIT (100 pikë)**

Për të pikëzuar aftësinë e inspektorit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së inspektorit bazuar në dosjet e përzgjedhura.

Vlerësuesi çmon aftësitë e inspektorit pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e inspektorit që vlerësohet.

### **A. Njohuritë ligjore (50 pikë)**

#### **a. Aftësia për të interpretuar ligjin (13 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorit për të interpretuar dispozitat ligjore të identifikuara dhe për t'i zbatuar ato kundrejt fakteve të çështjeve konkrete që janë në shqyrtim.

#### **Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- aftësinë për të interpretuar kriteret e pranueshmërisë së ankesës dhe për të marrë një vendim mbi përmbushjen e tyre;
- aftësinë për të identifikuar se cila dispozitë ligjore do të zbatohet ndaj shkeljes disiplinore në përputhje me faktet që përmban ankesa;
- aftësinë për të përdorur parimet e përgjithshme të legjislacionit të brendshëm dhe/ose ndërkombëtar, parimet e procesit të rregullt ligjor dhe të gjitha dispozitat ligjore në lidhje me rastet që shqyrtohen nga inspektori;
- aftësinë për të zbatuar parimet e përgjithshme të ligjit material dhe procedural në vlerësimin e fakteve të çështjes.

Vetëm përmendja e dispozitave ligjore dhe parimeve të përgjithshme, pa bërë edhe analizën e tyre që konsiston në mënyrën si ndërlidhen dispozitat ligjore dhe parimet me rrethanat e faktit, mund të jetë tregues i mungesës së aftësisë për të interpretuar ligjin. Vlerësuesi do të vlerësojë edhe aftësinë e inspektorit për t'ju referuar interpretimeve të ndryshme.

### **Burimet e vlerësimit**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë projektvendimet, relacionet apo raportet që përmbajnë analiza ligjore, të hartuara nga inspektori.

### **Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 13</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	13
Shumë mirë	10
Mirë	8
Mjaftueshëm	6
Pamjaftueshëm	5

#### **b. Aftësia për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe për të analizuar jurisprudencën (13 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorëve për të përdorur doktrinën juridike dhe praktikën gjyqësore në lidhje me aspekte të ndryshme të procedurave disiplinore të magistratëve. Qëllimi i vlerësimit do të jetë identifikimi i aftësisë së inspektorit për të interpretuar doktrinën juridike dhe praktikën gjyqësore të identifikuar dhe arsyetimin se si zbatohen ato ndaj fakteve të çështjes në shqyrtim.

#### **Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtëm:

- Aftësinë për të hulumtuar, identifikuar, analizuar dhe përdorur doktrinën juridike;
- Aftësinë për të hulumtuar, identifikuar, analizuar dhe përdorur standardet dhe parimet ndërkombëtare si KE, Parimet e Bangalores, etj.
- Aftësinë për të hulumtuar, identifikuar, analizuar dhe përdorur praktikën gjyqësore përkatëse, vendase dhe ndërkombëtare, siç janë praktika e unifikuar e Gjykatës së Lartë, praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese, e GJEDNJ-së dhe e gjithë jurisprudenca e konsoliduar, madje edhe në raste kur nuk përbën një burim të ligjit, por shërben për interpretimin e çështjeve konkrete në shqyrtim.

Nëse inspektori mjaftohet vetëm me referencën ndaj doktrinës juridike dhe praktikës gjyqësore, pa dhënë asnjë shpjegim se si ato ndihmojnë për zgjidhjen e çështjes konkrete, mund të jetë tregues i mungesës së aftësive për të përdorur doktrinën juridike dhe për të analizuar praktikën gjyqësore.



### Burimet e vlerësimit

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi janë projektvendimet, relacionet apo raportet që përmbajnë analiza ligjore, të hartuara nga inspektori.

### Tabela e pikëzimit të treguesit

<b>Pikë Totale 13</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	13
Shumë mirë	10
Mirë	8
Mjaftueshëm	6
Pamjaftueshëm	5

### c. Aftësia për të ndërtuar logjiksht hetimin në përputhje me kërkesat ligjore (12 pikë)

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorëve për të ndërtuar hetimet në një mënyrë logjike dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

#### Elementet e vlerësimit:

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- aftësinë për të përcaktuar faktet e çështjes;
- aftësinë për të identifikuar llojin e shkeljes disiplinore;
- aftësinë për të vendosur mbi veprimet e nevojshme hetimore dhe për t'i zbatuar ato brenda afatit të duhur në mënyrë që të respektojë afatet ligjore të shqyrtimit të ankesës.

### Burimet e vlerësimit

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë dokumentet ligjore të hartuara nga inspektori dhe të gjitha veprimet hetimore të kryera dhe të dokumentuara nga inspektori.

### Tabela e pikëzimit të treguesit

<b>Pikë Totale 12</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	12
Shumë mirë	10
Mirë	8
Mjaftueshëm	6
Pamjaftueshëm	5

### d. Aftësia për të mbledhur provat e kërkuara me ligj (12 pikë)

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorëve për të mbledhur provat që janë të nevojshme për të mbështetur hetimin disiplinor.

#### **Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Aftësinë për të mbledhur provat që janë të nevojshme për të mbështetur objektin e hetimit disiplinor;
- Kapaciteti për të analizuar provat të cilat janë të nevojshme për të mbështetur përfundimet e inspektorit mbi hetimin disiplinor;
- Mbledhja e provave që nuk janë në përputhje me objektin dhe qëllimin e hetimit dhe që nuk kontribuojnë në konkluzionet përfundimtare të hetimit, do të konsiderohet si tregues për mungesën e kapacitetit për të ndërtuar logjikisht hetimin.

#### **Burimet e Vlerësimit:**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë të gjitha provat e mbledhura dhe të administruara nga inspektori. Vlerësuesit do të analizojnë me kujdes dosjet e çështjeve të hetimeve disiplinore të ndjekura nga inspektori nën vlerësim.

#### **Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 12</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	12
Shumë mirë	10
Mirë	8
Mjaftueshëm	6
Pamjaftueshëm	5

### **B. Arsytimi ligjor (50 pikë)**

#### **a. Saktësia, qartësia dhe kuptueshmëria e projektvendimeve, relacioneve ose raporteve (13 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorit për të hartuar dokumente ligjore të qarta, të sakta, të kuptueshme, të lexueshme.

#### **Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- përdorimin e thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë të gjuhës;
- aftësinë për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë të jetë e mundur;
- zbatimin e saktë të rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës;
- përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës;

- përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), paragrafëve dhe e strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin;
- aftësia për të shkruar pa gabime ligjore dhe/ose materiale;
- përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë;
- shpreshtësia e kthimit të projektvendimit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe saktësia e përmbushjes së plotësimeve dhe korrigjimeve të kërkuara.

#### **Burimet e vlerësimit**

Burimet e vlerësimit për këtë tregues do të jenë dokumentet e hartuara nga inspektori.

#### **Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 13</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	13
Shumë mirë	10
Mirë	8
Mjaftueshëm	6
Pamjaftueshëm	5

#### **b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e arsyetimit të projektvendimeve, relacioneve ose raporteve (12 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorëve për të hartuar projektvendimin/relacionin/raportin me një strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar.

#### **Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi i këtij treguesi do të përqendrohet në faktin nëse struktura e akteve përmban elementet e mëposhtme:

- prezantimin e fakteve;
- identifikimin e dispozitave të zbatueshme të ligjit;
- analizën ligjore të fakteve;
- përfundimet;
- dispozitivin e vendimit.

#### **Burimet e vlerësimit:**

Burimet e vlerësimit të këtij indikator janë projektvendimet, relacionet ose raportet e hartuara nga inspektori.

#### **Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 12</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	12
Shumë mirë	10
Mirë	8
Mjaftueshëm	6
Pamjaftueshëm	5

**c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik (13 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorëve për të kryer një analizë cilësore bazuar në një përdorim logjik të koncepteve ligjore.

**Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Aftësinë për të identifikuar lidhjen shkakësore midis shkeljes së pretenduar, fakteve, provave dhe dispozitave ligjore;
- Aftësinë për të analizuar se si konceptet, institutet dhe dispozitat ligjore lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen në një situatë të caktuar;
- nëse niveli i arsytimit plotëson standardin e procesit të rregullt ligjor;
- nëse përmbajtja është gjithëpërfshirëse, duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve të hetimit disiplinor.

**Burimet e vlerësimit**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë dokumentet ligjore të hartuara nga inspektori.

**Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 13</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	13
Shumë mirë	10
Mirë	8
Mjaftueshëm	6
Pamjaftueshëm	5

**d. Aftësia për të marrë në pyetje (12 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorëve për të zbatuar detyrën e marrjes në pyetje gjatë hetimeve disiplinore.

**Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Aftësinë për të mbledhur informacionin përkatës duke kryer intervista dhe duke marrë në pyetje;
- aftësinë për të analizuar informacionin e mbledhur;
- aftësinë për të krahasuar gjetjet dhe për të nxjerrë përfundime nga pyetjet e ngritura dhe përgjigjet e marra.

Mbledhja gjatë intervistave, e informacionit, që dukshëm nuk është në përputhje me qëllimin e hetimit do të konsiderohet si mungesë e kapacitetit për të mbledhur informacionin përkatës.

### Burimet e vlerësimit

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë procesverbalet e intervistave dhe dokumente të tjerë të ngjashëm të hartuar nga inspektori.

### Tabela e pikëzimit të treguesit

<b>Pikë Totale 12</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	12
Shumë mirë	10
Mirë	8
Mjaftueshëm	6
Pamjaftueshëm	5

### TABELA E PËRGJITHSHME E REZULTATEVE PËR KRITERIN E AFTËSISË PROFESIONALE TË INSPEKTORIT

<b>Nr.</b>	<b>KRITERET VLERËSIMIT</b>	<b>E NËN - KRITERET E VLERËSIMIT</b>	<b>Niveli i aftësisë së inspektorit sipas kriterit të parë</b>	<b>Nr. i pikëve</b>
1.	<b>AFTËSIA PROFESIONALE</b> <b>100 Pikë</b>	<b>- Njohuritë ligjore</b>  <b>50 pikë</b>	Shkëlqyeshëm	
			Shumë mirë	
			Mirë	
			Mjaftueshëm	
			Pamjaftueshëm	
		<b>- Arsytimi ligjor</b>  <b>50 pikë</b>	Shkëlqyeshëm	
			Shumë mirë	
			Mirë	
			Mjaftueshëm	
			Pamjaftueshëm	



## 2. AFTËSIA ORGANIZATIVE E INSPEKTORIT (100 pikë)

Inspektori duhet të ketë aftësi të mira organizative në mënyrë që të jetë produktiv. Inspektori nuk mund të jetë efektiv pa pasur aftësinë për të organizuar dhe menaxhuar detyrat gjatë hetimit disiplinor. Produktiviteti varet nga menaxhimi i kohës, që tregon se sa efektivisht e përdor inspektori kohën, si kur inspekton i vetëm, ashtu edhe në grup me inspektorë të tjerë.

Inspektori duhet të bëjë përpjekjen maksimale si në menaxhimin efektiv të kohës, ashtu dhe në planifikimin e punës, pa krijuar pengesa në ecurinë e punës.

### A. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës (40 pikë)

#### a. Respektimi i afateve ligjore dhe plotësimi i standardeve minimale kohore (8 pikë)

Respektimi i afateve ligjore nënkupton respektimin nga ana e inspektorit të afateve të parashikuara në ligj brenda të cilave duhet të përfundojnë fazat e ndryshme procedurale të hetimit disiplinor dhe duhet të përfundojnë procedura e inspektimit në lidhje me ankesat apo inspektimet tematike.

#### Elementet e vlerësimit:

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Raportin midis numrit të çështjeve për të cilat inspektori e ka marrë vendimin në tejkalim të afatit ligjor krahasuar me numrin total të çështjeve të ndjekura nga inspektori që sipas ligjit kanë të njëjtat afate;
- vështirësinë e çështjes;
- volumin e çështjeve;
- rritjen e papritur e volumit të çështjeve;
- aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës;
- kërkesat e inspektorit për afate shtesë siç përcaktohet me ligj.

#### Burimet e vlerësimit

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë të dhënat statistikore të mbledhura nga ILD-ja të cilat japin informacion në lidhje me elementët e vlerësimit si dhe analiza e çështjeve dhe e rrethanave të tjera me ndikim.

#### Tabela e pikëzimit të treguesit

Pikë Totale 8	
Niveli	Pikët
Shkëlqyeshëm	8

Shumë mirë	6
Mirë	4
Mjaftueshëm	3
Pamjaftueshëm	2

**b. Koha mesatare që i dedikohet çdo detyre (8 pikë)**

Ky tregues vlerëson sasinë e kohës së shpenzuar nga çdo inspektor për shqyrtimin e rasteve. Ky tregues i referohet rasteve të hetuara brenda afateve ligjore.

**Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Koha mesatare të shpenzuar për çdo çështje nga inspektori;
- Eficenca e inspektorit gjatë zbatimit të të gjitha hapave të hetimit disiplinor;
- Vështirësia e çështjes;
- Rrethanat e tjera të cilat kanë ndikim tek koha mesatare;

**Burimet e vlerësimit:**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë të dhënat statistikore të mbledhura nga ILD-ja të cilat japin informacion në lidhje me elementet e vlerësimit si dhe analiza e çështjeve dhe e rrethanave të tjera me ndikim.

**Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 8</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	8
Shumë mirë	6
Mirë	4
Mjaftueshëm	3
Pamjaftueshëm	2

**c. Rendimenti i përfundimit të detyrës (8 pikë)**

Ky tregues vlerëson numrin e çështjeve të përfunduara nga inspektori gjatë periudhë së vlerësimit. Ky indikator i referohet të gjitha llojeve të përfundimit të një çështjeje, të tilla si arkivimi i ankesës, verifikimi i ankesës, fillimi i hetimit disiplinor, pezullimi i hetimit, mbyllja e hetimit dhe vendimi për të nisur procedimin disiplinor.

**Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- Numrin e vendimeve përfundimtare: vendimet e arkivimit; vendimet e verifikimit, vendimet për fillimin e hetimit; vendimet për mbylljen e hetimit; vendimet për pezullimin e hetimit; vendimet për fillimin e procedimit disiplinor;
- vështirësinë e çështjes;
- volumin e çështjeve;
- rritjen e papritur të volumit të çështjeve;
- rrethanat e tjera të cilat kanë ndikim;

#### **Burimet e Vlerësimit:**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë të dhënat statistikore, vlerësimet e mëparshme, opinionin i ILD-së, çështjet konkrete dhe dokumentet që provojnë rrethanat e tjera.

#### **Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 8</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	8
Shumë mirë	6
Mirë	4
Mjaftueshëm	3
Pamjaftueshëm	2

#### **d. Koha mesatare për përmbylljen e procesit të hartimit të akteve që janë detyrë e inspektorit (8 pikë)**

Ky tregues vlerëson kohën mesatare të shpenzuar nga inspektori për të marrë një vendim përfundimtar për çështjet e hetimit disiplinor të shqyrtuara gjatë vitit kalendarik.

#### **Elementet e vlerësimit**

Vlerësimi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- Kohën mesatare të shpenzuar për: vendimet e arkivimit; vendimet e verifikimit; vendimet për fillimin e hetimit; vendimet për mbylljen e hetimit; vendimet për pezullimin e hetimit; vendimet për fillimin e procedimit disiplinor;
- vështirësinë e çështjes;
- volumin e çështjeve;
- rritjen e papritur të volumit të çështjeve;
- rrethanat e tjera të cilat kanë ndikim;

#### **Burimet e vlerësimit**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë të dhënat statistikore, rastet e analizuara dhe rrethanat e tjera përkatëse.

#### **Tabela e pikëzimit të treguesit**



<b>Pikë Totale 8</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	8
Shumë mirë	6
Mirë	4
Mjaftueshëm	3
Pamjaftueshëm	2

**e. Koha mesatare e arsyetimit të akteve që janë detyrë e inspektorit (8 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorit për të arsyetuar në kohë sa më të shpejtë projektvendimet dhe raportet e tij.

**Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- Përlllogaritjen e datës së veprimit të fundit hetimor dhe datës së hartimit të projektvendimit/ raportit;
- Kohën e harxhuar si më sipër e cila krahasohet me afatin procedural të parashikuar nga ligji;
- vështirësinë e çështjes;
- volumin e çështjeve;
- rritjen e papritur të volumit të çështjeve;
- rrethanat e tjera të cilat kanë ndikim.

**Burimet e vlerësimit:**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë të dhënat statistikore, rastet e analizuara dhe rrethanat e tjera përkatëse.

**Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 8</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	8
Shumë mirë	6
Mirë	4
Mjaftueshëm	3
Pamjaftueshëm	2

**B. Aftësia e inspektorit për të kryer me efektivitet procedurat e verifikimit, të hetimit disiplinor ose inspektimit (40 pikë)**

**a. Aftësia e inspektorit për kryerjen e veprimeve hetimore dhe procedurale brenda afateve ligjore (20 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorëve për të kryer në mënyrë efektive veprimet hetimore dhe procedurale brenda afateve ligjore.

**Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- realizimin efektiv dhe në kohë të veprimeve përgatitore;
- numrin mesatar të veprimeve hetimore dhe procedurale të kryera brenda afateve ligjore për çdo çështje;
- numrin e veprimeve të duhura për çdo çështje, duke shmangur kryerjen disa herë të veprimeve hetimore dhe procedural, të cilat nuk janë të nevojshme për të provuar shkeljen, ose vonesën e veprimeve të nevojshme;
- kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për zgjidhjen e çështjes konkrete;
- vështirësinë e çështjes;
- volumin e çështjeve;
- ritjen e papritur të volumit të çështjeve;
- rrethanat e tjera të cilat kanë ndikim;

**Burimet e vlerësimit:**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë të dhënat statistikore, rastet e analizuara, rrethanat e tjera përkatëse, vlerësimi i mëparshëm dhe mendimi i ILD-së.

**Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 20</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	20
Shumë mirë	18
Mirë	15
Mjaftueshëm	10
Pamjaftueshëm	9

**b. Dërgimi pa vonesë i akteve të nevojshme të njoftimit (20 pikë)**

Ky tregues vlerëson angazhimin e inspektorëve për të përmbushur detyrimet duke dërguar dhe monitoruar dorëzimin e njoftimeve tek palët e përfshira, brenda afateve të parashikuara nga ligji.

**Elementet e vlerësimit**

Vlerësimi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- Dërgimin e akteve të njoftimit të çështjes brenda afateve ligjore dhe brenda kohës së nevojshme të kërkuar nga hetimi;
- Hartimin me shpejtësi dhe brenda afateve ligjore të akteve të njoftimit;

- Mbikëqyrjen nga inspektori të dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit;
- Marrjen e masave të tjera për të garantuar njoftime të rregullta;

### **Burimet e vlerësimit**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë aktet e njoftimit, afatet e tyre, ankesat e subjektit të hetimit për mangësitë e njoftimit dhe dokumente të tjera provuese.

### **Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 20</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	20
Shumë mirë	18
Mirë	15
Mjaftueshëm	10
Pamjaftueshëm	9

## **C. Aftësia e inspektorit për të administruar dosjet e detyrave të ngarkuara (20 pikë)**

### **a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes (10 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorëve për të mbajtur në rregull dosjen hetimore.

### **Burimet e vlerësimit**

Vlerësimi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- organizimin me një sistem të qartë arkivimi të dosjeve hetimore të inspektorit, që i bën ato lehtësisht të aksesueshme dhe të kuptueshme;
- ndjekjen e kronologjisë hetimore në organizimin e dokumenteve të dosjes;

### **Burimet e vlerësimit**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë dosjet hetimore të çështjeve të mbyllura të shqyrtuara nga inspektori;

### **Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 10</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	10
Shumë mirë	8
Mirë	6
Mjaftueshëm	5

Pa mjaftueshëm	4
----------------	---

**b. Plotësia dhe saktësia e dokumentacionit të dosjes (10 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorëve për të mbajtur në dosje të gjitha dokumentet e dosjes hetimore dhe vetëm ato dokumente që janë të sakta dhe lidhen me dosjet hetimore.

**Elementet e vlerësimit**

Vlerësimi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- përfshirjen në dosje të të gjitha akteve të prodhuara gjatë hetimit;
- mospërfshirjen nga dosja e hetimit të asnjë akti të lidhur me hetimin;
- saktësinë dhe lidhjen me çështjen hetimore specifike të dokumentacionit të përfshirë në dosjen e hetimit;

**Burimet e vlerësimit**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë dosjet hetimore të shqyrtuara nga inspektori.

**Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 10</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	10
Shumë mirë	8
Mirë	6
Mjaftueshëm	5
Pamjaftueshëm	4

**TABELA E PËRGJITHSHME E REZULTATEVE PËR KRITERIN E AFTËSIVE ORGANIZATIVE TË INSPEKTORIT**

Nr.	KRITERET VLERËSIMIT	E	- NËN KRITERET VLERËSIMIT	- E	Niveli i aftësisë së inspektorit sipas kriterit të dytë	Nr. i pikëve
			Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës	të	Shkëlqyeshëm	
					Shumë mirë	

2.	<b>AFTËSIA ORGANIZATIVE</b>  <b>100 Pikë</b>	40 pikë	Mirë		
			Mjaftueshëm		
			Pamjaftueshëm		
		Aftësia për të kryer me efektivitet procedurat e verifikimit, të hetimit disiplinor ose inspektimit	40 pikë	Shkëlqyeshëm	
				Shumë mirë	
				Mirë	
				Mjaftueshëm	
				Pamjaftueshëm	
		Aftësia për të administruar dosjet e detyrave të ngarkuara	20 pikë	Shkëlqyeshëm	
				Shumë mirë	
				Mirë	
Mjaftueshëm					
Pamjaftueshëm					

### 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE (100 pikë)

Pikëzimi i treguesve të këtij kriteri vlerësimi, bëhet sipas një rendi zbritës, bazuar në parimin që çdo inspektor, për shkak të statusit të tij ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Çdo inspektor e fillon procesin e vlerësimit me totalin e 100 pikëve referuar këtij kriteri të vlerësimit. Gjatë procedurës së vlerësimit, pikët mund të zbriten në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues të dalë nga burimet e vlerësimit krahasuar me ligjin, standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes të miratuara.

#### A. Etika në punë (20 pikë)

##### a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion

Ky tregues vlerëson angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion të inspektorit duke analizuar etikën në punë.

##### Elementet e vlerësimit:

Vlerësimi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- Aftësinë e inspektorit për të patur një sjellje të kujdesshme, objektive, me vetëpërmbytje dhe maturi gjatë ushtrimit të detyrës;
- Aftësinë e inspektorit për ta ushtruar detyrën në mënyrë korrekte, të ndërgjegjshme, sistematike dhe në kohë të arsyeshme;
- Shmangie e çdo sjelljeje që tregon mungesë respekti, ndjeshmërie, vëmendjeje apo qasje të papërshtatshme dhe fyese, pa u kufizuar vetëm në shmangien e sjelljeve të cilat zyrtarisht kualifikohen si në kundërshtim me ligjin.

### **Burimet e vlerësimit**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë:

- rezultatet e ankesave kundër inspektorëve dhe verifikimi i këtyre ankesave;
- mendimi i ILD-së lidhur me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion;
- vendimet përfundimtare për masat disiplinore të marra brenda periudhës së vlerësimit.

### **Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 20</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	20
Shumë mirë	18
Mirë	15
Mjaftueshëm	10
Pamjaftueshëm	9

## **B. Integriteti i inspektorit (40 pikë)**

### **a. Imuniteti ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm**

Integriteti i inspektorit, në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të tij, nënkupton imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi dhe presioni të jashtëm në ushtrimin e detyrës me nder dhe dinjitet.

#### **Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- Shmangien e lidhjeve të papërshtatshme me subjektet e hetimit disiplinor ose shmangien e sjelljeve që bëjnë të duket sikur ka lidhje të tilla të papërshtatshme;
- Ushtrimin e detyrës me nder dhe dinjitet në mënyrë që të përmbushin pritshmërinë e publikut;
- Shmangien e çdo paragjykimi që mund të jetë i dëmshëm ose mund të konsiderohet si i dëmshëm për hetimin;
- Shmangien e sjelljeve favorizuese apo disfavorizuese ndaj magjistratëve që janë subjekt i hetimit disiplinor apo përfaqësuesve të tyre;
- Vetëdijen e inspektorëve se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe besimit të publikut;
- Përcjellja nga inspektorët e vlerave personale dhe profesionale që i bëjnë të konsiderohen si shembuj të mirë për të tjerët;
- Shmangien e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për dinjitetin e palëve;
- Abuzimin me orarin e punës, personelin dhe burimet e institucionit për qëllime private;

- Përdorimi i substancave të ndaluara;
- Çdo sjellje ose veprimtari tjetër, që cënon ose mund të cënojë imazhin dhe figurën publike të inspektorit, të procedimit disiplinor dhe të ILD-së.

Si rrjedhojë, në përputhje me rrethanat e faktit dhe për caktimin e pikëve për këtë indikator, Komiteti mund të marrë në konsideratë opsionet që vijojnë:

a) nëse ka informacione mjaftueshëm të besueshme se inspektorit i mungon integriteti, Komisioni do të caktojë minimumin e pikëve të mundshme.

b) nëse nuk ka informacione në dispozicion që tregojnë se inspektorit i mungon integriteti, konkluzioni duhet të jetë në favor të inspektorit dhe Komiteti do të caktojë maksimumin e pikëve të mundshme.

### **Burimet e vlerësimit**

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në:

- rezultatet e ankesave kundër inspektorëve dhe verifikimin e këtyre ankesave;
- mendimin e ILD-së;
- vendimet përfundimtare për masat disiplinore të marra brenda periudhës së vlerësimit; dhe
- raportet e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

### **Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 40</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	40
Shumë mirë	35
Mirë	30
Mjaftueshëm	20
Pamjaftueshëm	19

### **C. Paanësia e inspektorit (40 pikë)**

Paanësia e inspektorit nënkupton mungesë paragjykimi në favor ose kundër palëve apo grupeve të veçanta.

#### **a. Kujdesi ndaj konfliktit të interesit (20 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorëve për të treguar paanshmëri në detyrë duke shmangur të gjitha rrethanat që çojnë në konflikt interesi.

#### **Elementet e vlerësimit**

Vlerësimi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- aftësinë për të shfaqur paanshmëri në detyrë;
- shmangien e të gjitha rrethanave që çojnë në konflikt interesi ose sjellje të njëanshme për shkak të konfliktit të interesit;
- Shmangien e sjelljeve që mund të krijojnë dyshime për mungesën e paanësisë;
- të vepruarit me drejtësi e cila do të jetë e dukshme për publikun;
- kërkesat e pranuar për përjashtimin e inspektorit për shkak të rasteve të konfliktit të interesave të cilat do të vlerësohen bazuar në elemente të tjerë siç janë: analiza krahasuese dhe shqyrtimi i sasisë së kërkesave për dorëheqje të paraqitura nga inspektori; mospranimi i penalizimit në rast se inspektori ka dhënë dorëheqjen paraprakisht nga verifikimi/hetimi i ankesës, por kërkesa e tij/saj nuk është pranuar nga ILD-ja.

### **Burimet e vlerësimit**

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në:

- kërkesat për përjashtimin e inspektorit për shkak të rasteve të konfliktit të interesave;
- në analizën e këtyre kërkesave, në aktet e dosjeve të inspektorit, në vlerësimin e mëparshëm, nëse ka, dhe në mendimin e ILD-së, në vendimet përfundimtare për masat disiplinore të marra brenda periudhës së vlerësimit dhe në dokumente të tjera zyrtare ose publike të vlefshme për këtë qëllim.

### **Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 20</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	20
Shumë mirë	18
Mirë	15
Mjaftueshëm	10
Pamjaftueshëm	9

### **b. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese (20 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorit për të shfaqur paanshmëri në detyrë duke shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese si dhe çdo tendencë për paragjykim. Qëndrimet personale nuk duhet të ndërhyjnë në vendimmarrjen e inspektorit.

#### **Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- shmangien e përdorimit të gjuhës diskriminuese;
- shmangien e çdo tendence për paragjykim;



- shmangien që mendimet personale ndaj grupeve vulnerabël të ndërhyjnë në vendimmarrjen e inspektorit;
- Respektimin e grupeve vulnerabël të tillë si: të miturit, viktimat e trafikimit, viktimat e dhunës në familje, personat me aftësi të kufizuar, personat që përfitojnë nga skemat e mbrojtjes sociale etj;

#### **Burimet e vlerësimit:**

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në vlerësimin e përdorimit të gjuhës diskriminuese nga inspektori në dokumente dhe/ose intervista, numrin tepër të lartë të kërkesave për përjashtimin e inspektorit për shkak të arsyeve të diskriminimit dhe burime të tjera vlerësimesh si p.sh. aktet e dosjeve të inspektorit, vlerësimin e mëparshëm nëse ka dhe mendimin e ILD-së.

#### **Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 20</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	20
Shumë mirë	18
Mirë	15
Mjaftueshëm	10
Pamjaftueshëm	9

#### **TABELA E PËRGGJITHSHME E REZULTATEVE PËR KRITERIN E ETIKËS DHE ANGAZHIMIT NDAJ VLERAVE PROFESIONALE TË INSPEKTORIT**

<b>Nr.</b>	<b>KRITERET VLERËSIMIT</b>	<b>E - NËN KRITERET VLERËSIMIT</b>	<b>- E</b>	<b>Niveli i aftësisë së inspektorit sipas kriterit të tretë</b>	<b>Nr. i pikëve</b>
3.	<b>ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE</b>  <b>100 Pikë</b>	<b>Etika në punë</b>  <b>20 pikë</b>		Shkëlqyeshëm	
				Shumë mirë	
				Mirë	
				Mjaftueshëm	
				Pamjaftueshëm	
		<b>Integriteti</b> <b>40 pikë</b>		Shkëlqyeshëm	
				Shumë mirë	
				Mirë	
				Mjaftueshëm	
		Pamjaftueshëm			

		<b>Paanësia</b>	Shkëlqyeshëm	
			Shumë mirë	
			Mirë	
			Mjaftueshëm	
			Pamjaftueshëm	
<b>40 pikë</b>				

#### 4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL (100 pikë)

Ky kriter vlerëson kapacitetin personal dhe angazhimin profesional të inspektorit që detajohet në treguesit e mëposhtëm.

##### A. Aftësia e komunikimit (30 pikë)

##### a. Komunikimi i qartë dhe transparent me palët, me publikun, entitete të tjera dhe të tretët (15 pikë)

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorit për të shfaqur komunikimin e duhur me subjektet e hetimit disiplinor, avokatët e tyre, publikun, institucione të tjera dhe palët e treta të përfshira gjatë procedurave të hetimit.

##### Elementet e vlerësimit:

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- aftësinë për të komunikuar në mënyrë efektive dhe për të qenë transparent në komunikim;
- aftësinë për t'u shprehur në një mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe koncize me subjektet e hetimit, përfaqësuesit e tyre, publikun, subjektet e tjera dhe të tretët.

##### Burimet e vlerësimit:

Burimet e vlerësimit të këtij indikator do të jenë teksti i akteve procedurale, njoftimet, procesverbalet e seancave dëgjimore dhe dokumente të tjerë ligjorë që përmbajnë elementë të rëndësishëm për qëllimin e vlerësimit, pavarësisht nëse ato paraqiten nga inspektori ose përzgjidhen me short. Burime të tjera vlerësimi do të jenë vlerësimi i inspektorit dhe opinioni i ILD-së.

##### Tabela e pikëzimit të treguesit

<b>Pikë Totale 15</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	15
Shumë mirë	13
Mirë	10
Mjaftueshëm	7
Pamjaftueshëm	6

**b. Respektimi i konfidencialitetit dhe parimit të mbrojtjes së të dhënave personale (15 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorëve për të treguar kujdes maksimal në ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të administruara gjatë procedurave të hetimit.

**Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- Respektimin e dispozitave ligjore për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale;
- Respektimin e udhëzimeve dhe akteve nënligjore të nxjerra nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të cilat mund të jenë të vlefshme për veprimtarinë e inspektorëve;
- Dhënia e një vëmendjeje të veçantë të të dhënave personale të kategorive vulnerabël si: të miturit, viktimat e dhunës në familje etj.

**Burimet e vlerësimit**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë ankesat kundër inspektorit për shkelje të mbrojtjes së të dhënave ose ndonjë dokument tjetër që dëshmon shkelje të rregullave të mbrojtjes së të dhënave nga inspektorët siç janë gjobat nga Komisioneri i Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe akte të ngjashme. Burime të tjera vlerësimi do të jenë aktet e dosjeve të inspektorit, vlerësimet e mëparshme, nëse ka dhe opinionin e ILD-së.

**Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 15</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	15
Shumë mire	13
Mirë	10
Mjaftueshëm	7
Pamjaftueshëm	6

**B. Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët (30 pikë)**

**a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me inspektorët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta (15 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë dhe disponueshmërinë e inspektorëve për të bashkëpunuar me kolegët dhe për të shkëmbyer njohuri dhe përvojë profesionale me ta pa ndikuar në pavarësi e në vendimmarrje.

**Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- bashkëpunimin e inspektorit me kolegët në aktivitete të ndryshme;
- angazhimin në zgjidhjen e problemeve për çështje ligjore specifike;
- përmirësimin e interpretimit ligjor, diskutimin mbi zbatimin e një praktike uniforme, mbështetjen në zhvillimin e modeleve të unifikuara të ILD-së;
- pjesëmarrjen në ndonjë veprimtari tjetër që lidhet me kompetencën e inspektorëve;
- gatishmërinë për të ndarë me kolegët përvojën e fituar në veprimtari të ndryshme trajnuese.

### **Burimet e vlerësimit**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë aktet e dosjeve të inspektorit, vlerësimi i mëparshëm nëse ka, mendimi i ILD-së dhe çdo dokument tjetër që dëshmon bashkëpunimin e inspektorit.

### **Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 15</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	15
Shumë mirë	13
Mirë	10
Mjaftueshëm	7
Pamjaftueshëm	6

### **b. Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën e Zyrës së ILD-së (15 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorëve për të bashkëvepruar rregullisht me administratën e Zyrës së ILD-së duke nxitur marrëdhënie bashkëpunimi me qëllim krijimin e një mjedisi pune harmonik dhe produktiv.

#### **Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- ndërveprimin e duhur me stafin e administratës së Zyrës së ILD-së;
- inkurajimin e marrëdhënieve bashkëpunuese me stafin e administratës së Zyrës së ILD-së;
- krijimin e një ambienti harmonik dhe produktiv të punës;
- shmangien e sjelljeve të pahijshme siç janë mungesa e respektit ndaj punonjësve të administratës, keqtrajtim sistematik, përdorim të gjuhës së papërshtatshme apo paragjykuese, përjashtim social etj.

### **Burimet e vlerësimit**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë ankesat kundër inspektorit nga personeli administrativ, vlerësimi i mëparshëm nëse ka dhe mendimi i ILD-së.

#### **Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 15</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	15
Shumë mirë	13
Mirë	10
Mjaftueshëm	7
Pamjaftueshëm	6

#### **C. Gatishmëria e inspektorit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera (40 pikë)**

##### **a. Pjesëmarrja e inspektorit në programe dhe në trajnime profesionale të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale (10 pikë)**

Ky tregues vlerëson angazhimin e inspektorëve në trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës dhe në aktivitete të tjera trajnuese, me qëllim zhvillimin profesional të inspektorëve. Një nga objektivat e vlerësimit të veprimtarisë profesionale është edhe identifikimi i nevojave për trajnim, duke i dhënë mundësi inspektorit t'i kushtojë kohë vetëpërmirësimit në lidhje me njohjen dhe zbatimin e ligjit, jurisprudencës dhe doktrinës.

#### **Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- kohën kushtuar studimit të doktrinës juridike dhe të jurisprudencës;
- frekuencën e pjesëmarrjes në programet e trajnimit që ofrojnë specializim, të organizuara nga institucione të tjera të trajnimit në nivel kombëtar ose ndërkombëtar;
- numrin e sesioneve të trajnimit, kohëzgjatja e tyre e përgjithshme dhe tema përkatëse;
- trajnimin afatgjatë, përfshirë trajnimin e specializuar afatshkurtër, të organizuar në periudha të ndryshme kohore (do të konsiderohet si një vlerë e shtuar për rritjen profesionale).

#### **Burimet e vlerësimit**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë informacionet zyrtare me shkrim të dërguara nga institucionet, që vërtetojnë pjesëmarrjen dhe përfshirjen e inspektorit në aktivitetet e trajnimit. Pjesëmarrja e inspektorit në trajnime vlerësohet bazuar në dokumentet e paraqitura nga ai/ajo, të cilat tregojnë rritjen profesionale.

**Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 10</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	10
Shumë mirë	8
Mirë	6
Mjaftueshëm	5
Pamjaftueshëm	4

**b. Pjesëmarrja e inspektorit në grupet e punës dhe në hartimin e akteve nënligjore dhe rregulloreve të ILD-së (10 pikë)**

Inspektori mund t'i kushtojë kohë të konsiderueshme përpunimit të akteve nënligjore, rregullave, metodologjive dhe akteve të tjera të ILD-së. Kjo veprimtari përbën një kontribut të rëndësishëm për institucionin dhe tregon kontributin real në aktet dhe dokumentet zyrtare.

**Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- Pjesëmarrjen në përpunimin e akteve nënligjore të ILD-së;
- Pjesëmarrjen në përpunimin e rregullave të ILD-së;
- Pjesëmarrjen në përpunimin e metodologjive të ILD-së;
- Pjesëmarrjen në përpunimin e formave standarde të ILD-së;
- Pjesëmarrjen në përpunimin e akteve dhe dokumenteve të tjera të ILD-së.

**Burimet e vlerësimit**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë aktet nënligjore, rregullat, metodologjitë, format standarde, aktet dhe dokumentet e tjera të ILD-së në hartimin dhe përpunimin e të cilave inspektori ka marrë pjesë. Do të jenë burime vlerësimi edhe dokumentet e brendshme të ILD-së që evidentojnë punën specifike të kryer për përpunimin e këtyre akteve dhe numrin e përafërt të ditëve të punuara në këto akte.

**Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 10</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	10
Shumë mirë	8
Mirë	6
Mjaftueshëm	5
Pamjaftueshëm	4

**c. Pjesëmarrja e inspektorit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe publikimet ligjore akademike (10 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë dhe gatishmërinë e inspektorëve për t'u përfshirë në veprimtari që kanë ndikim në përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe angazhimin e inspektorëve në veprimtari që përfshijnë botime akademike ligjore me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin e doktrinës.

**Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- disponueshmërinë e inspektorëve për të dhënë kontribut si ekspert/lehtësues në trajnimet specifike të Shkollës së Magjistraturës ose në aktivitete trajnuese të organizuara nga institucionet gjyqësore; aktivitete jashtë funksionit të ndjekura nga inspektori me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; veprimtari mësimore për çështje juridike;
- të punuarit me aktorët kryesorë për të rritur cilësinë e gjyqësorit dhe për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për sundimin e zbatimit të ligjit dhe çdo aktivitet tjetër të lidhur me fushën ligjore;
- lista e botimeve;
- natyra e botimeve të tilla si artikuj, kapituj, monografi ose botime të tjera shkencore, të botuara brenda dhe jashtë vendit;
- nëse botimi ka një numër identifikimi (ISBN, ISSN).

**Burimet e vlerësimit**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë dokumentet përkatëse që përmbajnë informacionin mbi pjesëmarrjen dhe/ose përfshirjen në aktivitete ndër-institucionale nga inspektori dhe dokumentet e verifikimit të mbledhura nga vlerësuesit si dhe botimet e ndryshme të paraqitura ose të njoftuara nga inspektori dhe verifikimet e vlerësuesit.

**Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 10</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	10
Shumë mirë	8
Mirë	6
Mjaftueshëm	5
Pamjaftueshëm	4

**d. Disponueshmëria e inspektorit për të udhëhequr dhe/ose trajnuar inspektorët e rinj (10 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë dhe disponueshmërinë e inspektorëve për të udhëhequr apo për të trajnuar inspektorët e emëruar rishtazi me qëllim vënien në dispozicion të përvojës së tyre profesionale por pa ndikuar në pavarësinë në vendimmarrje.

#### Elementet e vlerësimit:

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- udhëheqja dhe dhënia e orientimeve për inspektorët e rinj në lidhje me praktikën e unifikuar;
- trajnimi për praktikën e mëparshme dhe atë të unifikuar institucionale;
- gatishmëria për të ndarë me kolegët përvojën e fituar gjatë kohëzgjatjes së ushtrimit të detyrës ose pjesëmarrjes së aktiviteve të ndryshme trajnuese.

#### Burimet e vlerësimit

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë dokumentet përkatëse që përmbajnë informacion për udhëheqjen apo trajnimin e inspektorëve të rinj, vlerësimi i mëparshëm, nëse ka, mendimi i ILD-së dhe çdo dokument tjetër që dëshmon angazhimin e inspektorit.

#### Tabela e pikëzimit të treguesit

<b>Pikë Totale 10</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	10
Shumë mirë	8
Mirë	6
Mjaftueshëm	5
Pamjaftueshëm	4

#### TABELA E PËRGJITHSHME E REZULTATEVE PËR KRITERIN E AFTËSISË PERSONALE DHE ANGAZHIMIT PROFESIONAL TË INSPEKTORIT

<b>Nr.</b>	<b>KRITERET VLERËSIMIT</b>	<b>E - NËN KRITERET VLERËSIMIT</b>	<b>- E</b>	<b>Niveli i aftësisë së inspektorit sipas kriterit të katërt</b>	<b>Nr. i pikëve</b>
3.	<b>AFTËSIA PERSONALE DHE</b>	<b>Aftësitë komunikimit</b>	<b>30 pikë</b>	Shkëlqyeshëm	
				Shumë mirë	
				Mirë	
				Mjaftueshëm	
				Pamjaftueshëm	



	<b>ANGAZHIMI PROFESIONAL 100 Pikë</b>	<b>Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët 30 pikë</b>	Shkëlqyeshëm	
			Shumë mirë	
			Mirë	
			Mjaftueshëm	
		<b>Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera 40 pikë</b>	Pamjaftueshëm	
			Shkëlqyeshëm	
			Shumë mirë	
			Mirë	
			Mjaftueshëm	
			Pamjaftueshëm	

**ANEKSI Nr. 2**

**FORMULARI I VETËVLERËSIMIT TË INSPEKTORIT**

**Për periudhën 20\_\_ - 20 \_\_**

**TË DHËNAT E INSPEKTORIT**

**Emri:**

**Mbiemri:**

**Datëlindja:**

**Vendbanimi:**

**Adresa e e-mailit zyrtar:**

**Adresa e e-mailit personal:**

**Numër telefoni:**

---

## 1. Vlerësimi i aftësive profesionale të inspektorit.

*Me anë të kriterit të aftësisë profesionale të inspektorit vlerësohet aftësia e inspektorit në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor.*

### A. Njohuritë ligjore.

#### a. Aftësia për të interpretuar ligjin

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e inspektorit për të interpretuar dispozitat ligjore të identifikuara dhe për t'i zbatuar ato tek faktet e çështjes konkrete në shqyrtim.

Vlerësimi do të përfshijë analizimin e aftësisë së inspektorit për të interpretuar kriteret e pranueshmërisë së ankesës, aftësinë për të përcaktuar dispozitat ligjore që do të zbatohen për shkëlqen disiplinore bazuar në faktet e parashtruara në ankesë, aftësinë për të përdorur parimet e përgjithshme të legjislacionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar, parimet e një procesi të rregullt ligjor dhe të gjitha dispozitat që lidhen me çështjen në shqyrtim nga inspektori.

*Si e vlerëson inspektori shkallën e aftësisë së tij/saj? Pse? Referojuni rasteve kur projektvendimet tuaja janë pranuar nga ana e ILD-së dhe vendimeve të ILD-së që janë lënë në fuqi nga ana e Këshillave/Gjykatave.*

#### Shpjegime

#### b. Aftësia për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe për të analizuar jurisprudencën

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorit për të përdorur doktrinën juridike në lidhje me aspekte të ndryshme të procedimit disiplinor të magistratëve. Doktrina juridike mund të përfshijë parimet dhe standardet ndërkombëtare siç janë KE, Parimet e Bangalores etj.

Sipas këtij treguesi do të vlerësohet gjithashtu aftësia e inspektorit për të analizuar dhe përdorur praktikën gjyqësore, qoftë kombëtare ose ndërkombëtare, veçanërisht vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe çdo vendim tjetër edhe në rastet kur nuk përbën burim të së drejtës, por i shërben interpretimit të rasteve konkrete në shqyrtim.

*Si e vlerëson inspektori shkallën e aftësisë së tij/saj? Pse? Referojuni projektvendimeve të hartuara nga ana juaj.*

#### Shpjegime

**c. Aftësia për të ndërtuar logjikisht hetimin në përputhje me përcaktimet ligjore**

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e inspektorit për të përcaktuar faktet e çështjes, për të identifikuar llojin e shkeljes disiplinore, për të përcaktuar veprimet e nevojshme hetimore dhe për t'i zbatuar ato brenda afatit të duhur kohor, me qëllim që të zbatohen afatet ligjore të shqyrtimit të ankesës.

*Si e vlerëson inspektori shkallën e aftësisë së tij/saj? Pse? Referojuni hetimeve disiplinore të përfunduara nga ana juaj.*

**Shpjegime**

**d. Aftësia për të mbledhur provat e kërkuara nga ligji**

Ky tregues vlerëson aftësitë e inspektorit për të administruar dhe përmbledhur provat dhe për t'i lidhur ato me dispozitat e zbatueshme ligjore dhe objektin e hetimit disiplinor.

*Si e vlerëson inspektori shkallën e aftësisë së tij/saj? Pse? Referojuni hetimeve disiplinore të përfunduara nga ana juaj.*

**Shpjegime**

**B. Arsytimi ligjor.**

**a. Saktësia, qartësia dhe kuptueshmëria e projektvendimeve, relacioneve ose raporteve**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorit për të përdorur thjesht dhe drejtpërdrejt gjuhën, aftësinë për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë, zbatimin e saktë të rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës, përzgjedhjen e kujdesshme të gjuhës dhe përdorimin e të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), organizimin e paragrafëve dhe të strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin, përdorimin në mënyrë korrekte dhe konsistente të termave ligjorë, aftësinë për të shkruar pa gabime ligjore dhe/ose materiale, shpeshhtësinë e kthimit të projektvendimit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe saktësia e përmbushjes së plotësimeve dhe korrigjimeve të kërkuara.

*Si e vlerëson inspektori shkallën e aftësisë së tij/saj? Pse? Referojuni praktikës dhe udhëzimeve të ILD-së në rastet kur e ka kthyer projektvendimin, duke kërkuar rishikimin e tij.*

## Shpjegime

### **b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e arsyetimit të projektvendimeve, relacioneve ose raporteve**

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e inspektorit për të hartuar projektvendimet/relacionet/raportet sipas një strukture të qartë, të mirëorganizuar, ndjekur nga inspektori që përmban të paktën prezantimin e fakteve, identifikimin e dispozitës ligjore të zbatueshme, analizën ligjore të fakteve konkluzionet e arritura.

*Si e vlerëson inspektori shkallën e aftësisë së tij/saj? Pse? Referojuni praktikës dhe udhëzimeve të ILD-së në rastet kur e ka kthyer projektvendimin, duke kërkuar rishikimin e tij.*

## Shpjegime

### **c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.**

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e inspektorit për të kryer një analizë cilësore, mbi bazën e një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore. Argumentimi logjik nënkupton aftësinë e inspektorit për të identifikuar lidhjen shkak-pasojë, si edhe për të analizuar se si lidhen midis tyre konceptet, institutet dhe dispozitat, ose se si zbatohen ato në një situatë të caktuar. Në veçanti, vlerësohet nëse niveli i arsyetimit plotëson standardin e procesit të rregullt ligjor dhe nëse përmbajtja është gjithëpërfshirëse, duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve në hetimin disiplinor.

*Si e vlerëson inspektori shkallën e aftësisë së tij/saj? Pse? Referojuni projektvendimeve të hartuara gjatë periudhës së vlerësimit.*

## Shpjegime

### **d. Aftësia për të marrë në pyetje**

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e inspektorit për të mbledhur informacionin e nevojshëm duke kryer intervista dhe duke analizuar të dhënat e mbledhura, për të krahasuar gjetjet dhe për të arritur në përfundime në lidhje me pyetjet e tij/saj.

*Si e vlerëson inspektori shkallën e aftësisë së tij/saj? Pse? Referojuni hetimeve disiplinore të përfunduara.*

**Shpjegime**

Nr.	Kriteri i vlerësimit	Nën-kriteret e vlerësimit	Niveli i aftësisë së inspektorit për kriterin e parë	Nr. i pikëve
1.	<b>AFTËSITË PROFESIONALE 100 Pikë</b>	<b>- Njohuritë ligjore 50 Pikë</b>	Shkëlqyeshëm	
			Shumë mirë	
			Mirë	
			Mjaftueshëm	
			Pamjaftueshëm	
		<b>- Arsyetimi ligjor 50 Pikë</b>	Shkëlqyeshëm	
			Shumë mirë	
			Mirë	
			Mjaftueshëm	
			Pamjaftueshëm	

**2. Vlerësimi i aftësive organizative të inspektorit.**

Me anë të kriterit të aftësive organizative vlerësohet aftësia e inspektorit për të përballuar efektivisht ngarkesën në punë, për të administruar dhe kontrolluar efektivisht procedurat hetimore si dhe aftësia për të administruar dosjen hetimore.

**A. Aftësia e inspektorit për të përballuar ngarkesën në punë.**

**a. Respektimi i afateve ligjore dhe plotësimi i standardeve minimale kohore.**

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e inspektorit për respektimin e afateve të parashikuara nga ligji brenda të cilave duhet të përfundojnë fazat e ndryshme procedurale të hetimit disiplinor. Vlerësimi bëhet referuar raportit midis çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të afatit ligjor, krahasuar me numrin total të çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon të njëjtin afat.

*Inspektori bën një analizë të pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh shkallën e aftësisë së tij/saj. Në rastet e vonesave domethënëse ose të vonesave në shumë çështje, inspektori do të japë arsyet e tij/saj.*

**Shpjegime**

**b. Koha mesatare që i dedikohet çdo detyre**

Ky tregues i referohet rasteve të hetuara brenda afateve ligjore dhe mat kohën mesatare që inspektori ka shpenzuar për një çështje, në mënyrë që të vlerësohet eficientia e inspektorit gjatë zbatimit të të gjitha etapave të hetimit disiplinor. Në vlerësimin e këtij treguesi do të merret parasysh edhe kompleksiteti i çështjes.

Ky tregues do të vlerësohet bazuar në të dhëna konkrete sipas statistikave.

*Inspektori bën analizën e pavarur të të dhënave statistikore dhe përzgjedh shkallën e aftësisë së tij/saj.*

**Shpjegime**

**c. Rendimenti i përfundimit të detyrës**

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e inspektorit për të përfunduar hetimet disiplinore, krahasuar me numrin total të çështjeve të ndjekura nga inspektori përgjatë vitit kalendarik. Ky vlerësim do të marrë në konsideratë numrin e vendimeve për arkivimin e ankesës, verifikimin e ankesës, fillimin e hetimit disiplinor, pezullimin e hetimit, mbylljen e hetimit dhe vendimin për fillimin e procedimit disiplinor.

*Inspektori bën analizën e pavarur të të dhënave statistikore dhe përzgjedh shkallën e aftësisë së tij/saj.*

## Shpjegime

### **d. Koha mesatare për përmbylljen e procesit të hartimit të akteve që janë detyrë e inspektorit**

Në këtë tregues vlerësohet koha mesatare e inspektorit për të marrë një vendim përfundimtar mbi hetimet disiplinore të shqyrtuara përgjatë një viti kalendarik siç mund të jenë arkivimi, mbyllja e hetimit disiplinor apo fillimi i procedimit disiplinor në Këshilla. Gjatë vlerësimit të këtij treguesi do të merret në konsideratë edhe kompleksiteti i çështjes.

*Inspektori bën analizën e pavarur të të dhënave statistikore dhe përzgjedh shkallën e aftësisë së tij/saj.*

## Shpjegime

### **d. Koha mesatare e arsyetimit të akteve që janë detyrë e inspektorit**

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e inspektorit për të arsyetuar në kohë sa më të shpejtë projektvendimet. Koha mesatare e arsyetimit për të gjitha projektvendimet e inspektorit gjatë gjithë fazave të hetimit disiplinor, llogaritet nga data e caktimit të çështjes deri në datën e hartimit të vendimit. Në rastet e hetimeve disiplinore, koha mesatare do të llogaritet nga data e veprimtimit të fundit hetimor deri në datën e hartimit të projektvendimit. Ky tregues krahasohet me afatet procedurale të përcaktuara në ligj. Gjatë vlerësimit të këtij treguesi do të merret në konsideratë edhe kompleksiteti i çështjes.

*Inspektori bën analizën e pavarur të të dhënave statistikore dhe përcakton shkallën e aftësisë së tij/saj.*

## Shpjegime

### **B. Aftësia e inspektorit për të kryer me efektivitet procedurat e verifikimit, të hetimit disiplinor ose inspektimit**



#### **a. Kryerja e veprimeve hetimore dhe procedurale brenda afateve ligjore**

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e inspektorit për kryerjen efektive të veprimeve hetimore dhe procedurale brenda afateve ligjore. Synimi i indikatorit është të vlerësojë aftësinë e inspektorit për të vendosur mbi numrin e verimeve të duhura për secilën çështje, duke shmangur veprimet që nuk janë të nevojshme për të provuar shkeljen dhe garantimin që janë kryer të gjitha veprimet për zgjidhjen e çështjes konkrete.

Efienca e inspektorit vlerësohet duke llogaritur numrin mesatar të veprimeve hetimore dhe procedurale për çdo çështje, të kryer brenda afateve ligjore.

Do të vlerësohen veprimet si vijon: kryerja në kohë e veprimeve hetimore përgatitore, planifikimi efektiv dhe kryerja e veprimeve përgatitore, ndjekja me përpikmëri e të gjitha etapave të hetimeve disiplinore dhe të inspektimeve të tij.

*Si e vlerëson inspektori aftësinë e tij/saj? Referojuni hetimeve të kryera nga ana juaj.*

**Shpjegime**

#### **b. Dërgimi pa vonesë i akteve të nevojshme të njoftimit.**

Në këtë tregues vlerësohet përkushtimi i inspektorit për të përmbushur detyrimet e tij/saj duke dërguar dhe mbikqyrur dërgimin e njoftimeve tek palët e përfshira, brenda afateve të parashikuara në ligj.

Për të matur efencën e inspektorit për këtë tregues, do të shqyrtohet nëse janë dërguar aktet e njoftimit brenda afateve ligjore dhe brenda kohës së nevojshme, që kërkohet nga hetimi.

*Inspektori kryen një analizë të pavarur të të dhënave statistikore dhe vlerëson aftësitë e tij/saj në pëputhje me to.*

**Shpjegime**

#### **C. Aftësia e inspektorit për të administruar dosjet e detyrave të ngarkuara**

##### **a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes**

Ky tregues vlerëson aftësin e inspektorit për të mbajtur dosjen hetimore të rregullt. Për vlerësimin e këtij treguesi do të matet nëse dosjet e inspektorit janë organizuar sipas një sistemi të qartë arkivimi, i cili i bën ato lehtësisht të identifikueshme dhe të aksesueshme. Për shembull, renditja sipas datës së dokumenteve, sipas llojit të dokumenteve etj. Dosja duhet të ndjekë rendin kronologjik të veprimeve hetimore.

*Si e vlerëson inspektori shkallën e aftësisë së tij/saj? Inspektori kryen një analizë të pavarur mbi aftësitë e tij/saj duke shpjeguar sistemin e përdorur për renditjen e dokumenteve të dosjes.*

#### Shpjegime

#### b. Plotësia dhe saktësia e dokumentacionit të dosjes.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e inspektorit për të garantuar që dosja të përmbajë të gjitha aktet e prodhuara gjatë hetimit pa përjashtuar asnjë akt dhe që dokumentacioni i përfshirë në dosje të jetë i saktë dhe t'i përkasë çështjes konkrete.

*Si e vlerëson inspektori shkallën e aftësisë së tij/saj?*

#### Shpjegime

Nr.	Kriteri i vlerësimit	Nën kriteret e vlerësimit	Niveli i aftësisë së inspektorit për kriterin e dytë	Nr. i pikëve
2.	AFTËSITË ORGANIZATIVE;  100 Pikë	- Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës 40 Pikë	Shkëlqyeshëm	
			Shumë mirë	
			Mirë	
			Mjaftueshëm	
			Pamjaftueshëm	
		- Aftësia e inspektorit për të kryer me efektivitet procedurat e verifikimit, të hetimit disiplinor ose inspektimit 40 Pikë	Shkëlqyeshëm	
			Shumë mirë	
			Mirë	
			Mjaftueshëm	
			Pamjaftueshëm	

		- Aftësia për të administruar dosjen e detyrave të ngarkuara 20 Pikë	Shkëlqyeshëm	
			Shumë mirë	
			Mirë	
			Mjaftueshëm	
			Pamjaftueshëm	

### 3. Vlerësimi i etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

Pikëzimi i këtij treguesi vlerësimi bëhet mbi bazën e parimit kushtetues që çdo inspektor për shkak të statusit të tij duhet të sillet me etikë, integritet dhe paanësi. Procesi i vlerësimit për këtë kriter bazohet në parimin e prezumimit të pasjes së vlerave të tilla themelore në lidhje me ushtrimin e detyrës.

#### A. Etika në punë

##### a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e inspektorit për të shfaqur sjellje të kujdesshme, objektive, vetëpërmbytje dhe maturi. Të veprojë gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë korrekte, të ndërgjegjshme, sistematike dhe brenda një kohë të arsyeshme, duke shmangur në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me vërtetësi çdo sjellje që tregon mungesë respekti, mungesë ndjeshmërie, vëmendjeje apo çdo qasje të papërshtatshme e fyese dhe duke mos u kufizuar vetëm në shmangien e atyre sjelljeve që formalisht janë në kundërshtim me ligjin.

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në rezultatet e ankesave kundër inspektorit dhe verifikimit të këtyre ankesave, në mendimin e ILD-së dhe vendimet përfundimtare të masave disiplinore të marra gjatë periudhës së vlerësimit.

*Inspektori kryen një analizë të pavarur të ankesave, mendimit të ILD-së dhe të vendimeve përfundimtare për masat disiplinore dhe zgjedh shkallën e aftësisë. Inspektori mund të japë mendim mbi këto akte.*

Shpjegime

#### B. Integriteti

##### a. Imuniteti ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e inspektorit për të respektuar, zbatuar dhe mbështetur vlerat themelore të punës së tij, siç janë shmangia e lidhjeve të papërshtatshme me subjektet e hetimit disiplinor ose shmangia e sjelljeve që japin përshtypjen se ekzistojnë lidhje të papërshtatshme, duke e ushtruar funksionin me nder, dinjitet në mënyrë që të respektohen pritshmëritë publike.

Gjatë ushtrimit të detyrës, inspektori duhet të përpiqet të shmangë të gjitha paragjykimet që mund të dëmtojnë ose të konsiderohen si të dëmshme për hetimin. Inspektorët nuk duhet të favorizojnë ose të disfavorizojnë magistratët nën hetim disiplinor ose avokatët e tyre.

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në rezultatet e ankesave kundër inspektorit dhe verifikimit të këtyre ankesave, në mendimin e ILD-së dhe vendimet përfundimtare mbi masat disiplinore të marra gjatë periudhës së vlerësimit si dhe raportet e ILDKPKI-së.

*Inspektori kryen një analizë të pavarur të ankesave, të mendimeve të ILD-së, të vendimeve përfundimtare mbi masat disiplinore, të raporteve të ILDKPKI-së dhe zgjedh nivelin e aftësive të tij/saj... Inspektori mund të japë mendim mbi këto akte.*

#### Shpjegime

### C. Paanësia

#### a. Kujdesi ndaj konfliktit të interesit.

Ky tregues mat aftësinë e inspektorit për të treguar paanshmëri në detyrë, duke shmangur të gjitha rrethanat të cilat krijojnë konflikt të interesit.

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në rezultatet e kërkesave për përjashtimin e inspektorit për shkak të konfliktit të interesit.

*Inspektori bën një analizë të pavarur të kërkesave për përjashtim dhe përzgjedh nivelin e aftësive të tij/saj. Inspektori mund të japë mendim mbi këto kërkesa.*

#### Shpjegime

#### b. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e inspektorit për të shfaqur paanshmëri në detyrë duke shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese si dhe çdo tendencë për paragjykime.

Vlerësimi do të bazohet në shqyrtimin e përdorimit të gjuhës diskriminuese nga ana e inspektorit në dokumenta dhe/ose intervista, në numrin jashtëzakonisht të lartë të kërkesave për përjashtimin e inspektorit, për shkak të arsyeve diskriminuese dhe burime të tjera vlerësimi.

*Inspektori bën një analizë të pavarur të dokumentave që përmbajnë akuza diskriminimi dhe përzgjedh nivelin e aftësisë së tij/saj. Inspektori mund të japë mendim mbi këto dokumente.*

#### Shpjegime

Nr.	Kriteri i vlerësimit	Nën kriteret e vlerësimit	Niveli i aftësisë së inspektorit për kriterin e tretë	Nr. i pikëve
3.	<b>ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE</b>	<b>- Etika në Punë</b>  <b>20 pikë</b>	Shëlqyeshëm	
			Shumë mirë	
			Mirë	
			Mjaftueshëm	
			Pamjaftueshëm	
		<b>- Integriteti</b>  <b>40 pikë</b>	Shëlqyeshëm	
			Shumë mirë	
			Mirë	
			Mjaftueshëm	
			Pamjaftueshëm	
		<b>- Paanësia</b>  <b>40 pikë</b>	Shëlqyeshëm	
			Shumë mirë	
			Mirë	
			Mjaftueshëm	
		Pamjaftueshëm		

#### 4. Vlerësimi i aftësive personale dhe angazhimit profesional.

Me anë të këtij kriteri vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i inspektorit, duke vlerësuar aftësitë komunikuese, aftësinë për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e ILD-së, gatishmëria e inspektorit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

##### A. Aftësia e komunikimit.

**a. Komunikimi i qartë dhe transparent me palët, me publikun, entitetet e tjera dhe palët e treta**

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e inspektorit për të qenë transparent në komunikim dhe për t'u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe konçize me palët e hetimit disiplinor, përfaqësuesit e tyre, publikun, subjektet e tjera dhe të tretët.

Ky vlerësim do të bëhet duke u bazuar në tekstin e akteve procedurale, njoftimet dhe procesverbalet e intervistave dhe dëgjësive apo dokumenteve të tjera që pasqyrojnë komunikimin.

*Si e vlerëson inspektori aftësinë për të komunikuar qartë dhe në mënyrë transparente? Pse? Referojuni rasteve dhe praktikës tuaj.*

**Shpjegime**

**b. Respektimi i konfidencialitetit dhe parimit të mbrojtjes së të dhënave personale**

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e inspektorit për të treguar kujdesin maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me informacionet dhe të dhënat për të cilat vihet në dijeni për shkak të funksionit, siç mund të jenë çështjet me të mitur, ato të dhunës në familje, etj.

Vlerësimi do të bazohet tek të gjitha ankesat ndaj inspektorit në lidhje me shkelje të parimit të mbrojtjes së të dhënave personale ose mbi çdo dokument tjetër që tregon shkelje nga inspektori të rregullave për mbrojtjen e të dhënave.

*Si e vlerëson inspektori aftësinë në lidhje me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale? Referojuni rasteve tuaja.*

**Shpjegime**

**B. Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët**

**a. Komunikimi dhe bashkëpunimi me inspektorët, shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta**

Në këtë tregues vlerësohet aftësia dhe disponibiliteti i inspektorit për të bashkëpunuar me kolegët dhe për të shkëmbyer me ta njohuritë dhe aftësitë profesionale pa cënuar pavarësinë në vendimmarrje.

Vlerësimi do të bazohet në veprimtaritë e bashkëpunimit të kryera nga inspektori të tilla si angazhimi në ngritjen e problematikave mbi çështje të caktuara juridike, përmirësimi i interpretimit të legjislacionit, diskutimi rreth zbatimit të praktikave uniforme, mbështetje në zhvillimin e modeleve të unifikuara të ILD-së dhe pjesëmarrja në çdo veprimtari tjetër që lidhet me kompetencën dhe vullnetin e inspektorit për të ndarë me kolegët përvojën e fituar gjatë veprimtarive të ndryshme trajnuese.

*Si e vlerëson inspektori shkallën e aftësisë në lidhje me komunikimin dhe bashkëpunimin me kolegët?*

**Shpjegime**

**b. Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën e Zyrës së ILD-së**

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e inspektorit për të ndërvepruar rregullisht me personelin e institucionit, nxitja e marrëdhënieve bashkëpunuese me qëllim krijimin e një ambienti pune harmonik dhe produktiv.

*Si e vlerëson inspektori aftësinë në lidhje me komunikimin dhe bashkëpunimin me administratën e institucionit?*

**Shpjegime**

**C. Gatishmëria e inspektorit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera**

**a. Pjesëmarrja e inspektorit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.**

Me këtë tregues vlerësohet angazhimi i inspektorit në trajnimet e Shkollës së Magjistraturës si dhe në aktivitete të tjera trajnuese, me qëllim rritjen profesionale të inspektorit.

*A i ka ndjekur inspektori trainimet profesionale gjatë periudhës së vlerësimit?*

**Shpjegime** (Këtu inspektori duhet të japë të dhëna për pjesëmarrjen në aktivitete trajnimi, duke specifikuar përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e trajnimit si dhe informacione në lidhje me institucionin që ka organizuar trajnimin. Dokumentacioni përkatës t'i bashkëlidhet formularit)

**b. Pjesëmarrja e inspektorit në grupet e punës dhe në hartimin e akteve nënligjore dhe rregulloreve të ILD**

Inspektori mund t'i kushtojë një kohë të kosiderueshme hartimit të akteve nënligjore, rregullave dhe metodologjive apo akteve të tjera të ILD-së. Kjo përbën një kontribut thelbësor për institucionin dhe tregon kontributin e vërtetë të inspektorit lidhur me aktet formale dhe dokumentet.

**Shpjegime** (Këtu inspektori duhet të listojë aktet nënligjore, rregullat, metodologjitë dhe aktet e tjera të ILD-së në hartimin e të cilave ka marrë pjesë duke përshtetur punën specifike të kryer për hartimin e këtyre akteve dhe numrin e përafërt të ditëve të punës për këto akte).

**c. Pjesëmarrja e inspektorit në veprimtari ndërinstytucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe publikimet ligjore akademike**

Me këtë tregues vlerësohet aftësia dhe vullneti i inspektorit për t'u angazhuar në veprimtari, për të përmirësuar sistemin e drejtësisë dhe angazhimin e inspektorëve në veprimtari që përfshijnë botime akademike ligjore me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin e doktrinës. Ky vlerësim do të bazohet në veprimtaritë jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupet kyç të interesit me qëllim rritjen e cilësisë së sistemit të drejtësisë dhe ndërgjegjësimin e publikut për respektimin e shtetit ligjor, si edhe çdo veprimtari tjetër të ngjashme në fushën juridike; hartimin e artikujve, kapitujve, monografive, ose publikimeve shkencore të tjera, të botuara brenda dhe jashtë vendit, të shoqëruara me numër identifikimi (ISBN, ISSN).

**Shpjegime** (Inspektori duhet të listojë këtu informacione mbi pjesëmarrjen dhe/ose përfshirjen në veprimtari ndërinstytucionale si më sipër. Dokumentacionin përkatës ia bashkëlidh formularit).

**d. disponueshmëria e inspektorit për të udhëhequr dhe/ose trajnuar inspektorët e rinj.**



Ky tregues vlerëson aftësinë dhe disponueshmërinë e inspektorëve për të udhëhequr apo për të trajnuar inspektorët e emëruar rishtazi, me qëllim vënien në dispozicion të përvojës së tyre profesionale por pa ndikuar në pavarësinë në vendimarrje.

**Shpjegime** (*Inspektori duhet të listojë informacion për udhëheqjen apo trajnimin e inspektorëve të rinj, çdo dokument tjetër që dëshmon angazhimin e inspektorit. Dokumentacionin përkatës ia bashkëlidh formularit.*)

Nr.	Kriteri i vlerësimit	Nën kriteret e vlerësimit	Niveli i aftësisë së inspektorit për kriterin e katërt	Nr. i pikëve
4.	<b>AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL</b>  <b>100 Pikë</b>	- <b>Aftësitë e komunikimit</b>  <b>30 pikë</b>	Shëlqyeshëm	
			Shumë mirë	
			Mirë	
			Mjaftueshëm	
			Pamjaftueshëm	
		- <b>Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët</b>  <b>30 pikë</b>	Shëlqyeshëm	
			Shumë mirë	
			Mirë	
			Mjaftueshëm	
			Pamjaftueshëm	
		- <b>Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.</b>  <b>40 pikë</b>	Shëlqyeshëm	
			Shumë mirë	
			Mirë	
			Mjaftueshëm	
			Pamjaftueshëm	

Në referim të nenit 86, pika 1, shkronja “c”, “ç”, “d”, “dh” të “Ligjit për Statusin” inspektori jep mendim për sa më poshtë:

- a. Masat e ndërmarra për përmbushjen e objektivave të përcaktuar në vlerësimin e mëparshëm dhe shkalla e përmbushjes së tyre.

**Shpjegime**

**b. Objektivat për zhvillimin e tij profesional për vlerësimin e ardhshëm.**

**Shpjegime**

**c. Nevojat për trajnim dhe rrethanat të cilat përbëjnë pengesë për zhvillimin e tij profesional duke propozuar zgjidhje konkrete për periudhën e ardhshme të vlerësimit.**

**Shpjegime**

**Në referim të nenit 86, pika 2 të “Ligjit për Statusin” inspektori i bashkëlidh formularit të vetëvlerësimit dy projektvendime të përzgjedhura prej tij, për çdo vit të periudhës së vlerësimit.**

**a. Vendimet e përzgjedhura nga inspektori.**

*Projektendimet e përzgjedhura listohen në këtë rubrikë dhe i bashkëlidhen formularit të vlerësimit.*

**Për t’u plotësuar nga inspektori**

**Plotësuar nga:**

**Emër:**

**Mbiemër:**

**Nënshkrimi:**

**Dorëzuar tek Komisioni në datë:**

**Marrë në dorëzim nga:**

**Emër:**

**Mbiemër:**

**Nënshkrimi:**

**Për t'u plotësuar nga Komisioni**

**Plotësuar nga:**

**Emër:**

**Mbiemër:**

**Nënshkrimi:**

**PROJEKTRAPORTI  
I VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË INSPEKTORIT**

MODEL  
Tiranë më \_\_/\_\_/2021

**Përgatiti: Komisioni i Emërimit dhe Vlerësimit**

**NDARJA<sup>1</sup> A – TË DHËNAT E INSPEKTORIT**

*Në këtë rubrikë plotësohen të dhënat personale të inspektorit dhe periudhën e vlerësimit.*

**Emri:**

**Mbiemri:**

**Datëlindja:**

**Vendbanimi:**

**Adresa e e-mailit zyrtar:**

**Adresa e e-mailit privat:**

**Numër telefoni:**

**Periudha e vlerësimit:**

**NDARJA B – QËLLIMI**

*Raporti i Vlerësimit i përgatitur nga Komisioni i Emërimit dhe Vlerësimit është një raport ndihmës në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të inspektorit, i cili ka për qëllim renditjen e të gjitha burimeve të marra gjatë procedurës së vlerësimit, paraqitjen e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit duke i përshkruar dhe/ose analizuar, në varësi të treguesve për çdo kriter vlerësimi.*

**NDARJA C - BURIMET E VLERËSIMIT**

---

<sup>1</sup> Ndarjet dhe emërtimet e tyre me shkronja pasqyrohen në këtë raport model për të orientuar pjesët e veçanta të aktit.

*Në këtë rubrikë listohen burimet e vlerësimit sipas parashikimeve të nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, të individualizuara për inspektorin për të cilin hartohet raporti analitik.*

1. Burimi 1
2. Burimi 2
3. Burimi 3
4. ....

#### **NDARJA D – PASQYRIMI DHE/OSE ANALIZA E TË DHËNAVE TË BURIMEVE TË VLERËSIMIT, NË VARËSI TË KRITEREVE TË VLERËSIMIT**

*Në këtë rubrikë listohen burimet e vlerësimit, pasqyrohen dhe/ose analizohen të dhënat që rezultojnë nga këto burime, në varësi të treguesve të përcaktuar në Metodologjinë e Vlerësimit, për secilin nga katër kriteret e vlerësimit.*

#### **1. AFTËSIA PROFESIONALE E INSPEKTORIT (100 pikë)**

Për të pikëzuar aftësinë e inspektorit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së inspektorit bazuar në dosjet e përzgjedhura.

Vlerësuesi çmon aftësitë e inspektorit pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e inspektorit që vlerësohet.

##### **A. Njohuritë ligjore (50 pikë)**

###### **a. Aftësia për të interpretuar ligjin (13 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorit për të interpretuar dispozitat ligjore të identifikuara dhe për t'i zbatuar ato kundrejt fakteve të çështjeve konkrete që janë në shqyrtim.

###### **Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Aftësinë për të interpretuar kriteret e pranueshmërisë së ankesës dhe për të marrë një vendim mbi përmbushjen e tyre;
- Aftësinë për të identifikuar se cila dispozitë ligjore do të zbatohet ndaj shkeljes disiplinore në përputhje me faktet që përmban ankesa;
- Aftësinë për të përdorur parimet e përgjithshme të legjislacionit të brendshëm dhe/ose ndërkombëtar, parimet e procesit të rregullt ligjor, dhe të gjitha dispozitat ligjore në lidhje me rastet që shqyrtohen nga inspektori;
- Aftësinë për të zbatuar parimet e përgjithshme të ligjit material dhe procedural, në vlerësimin e fakteve të çështjes.

Vetëm përmendja e dispozitave ligjore dhe parimeve të përgjithshme, pa bërë edhe analizën e tyre që konsiston në mënyrën si ndërliiden dispozitat ligjore dhe parimet me rrethanat e faktit, mund të jetë tregues i mungesës së aftësisë për të interpretuar ligjin. Vlerësuesi do të vlerësojë edhe aftësinë e inspektorit për t'ju referuar interpretimeve të ndryshme.

**Burimet e vlerësimit:**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë projektvendimet, relacionet apo raportet që përmbajnë analiza ligjore, të hartuara nga inspektori.

**Tabela e pikëzimit të treguesit**

Pikë Totale 13	
Niveli	Pikët
Shkëlqyeshëm	
Shumë mirë	
Mirë	
Mjaftueshëm	
Pamjaftueshëm	

**Burimet e vlerësimit:**

1. Burimi 1;
2. Burimi 2;
3. ....

**Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:**

**Referuar burimit 1,** rezulton se .....

**Referuar burimit 2,** rezulton se .....

**b. Aftësia për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe për të analizuar jurisprudencën (13 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorëve për të përdorur doktrinën juridike dhe praktikën gjyqësore në lidhje me aspekte të ndryshme të procedurave disiplinore të magjistratëve. Qëllimi i vlerësimit do të jetë identifikimi i aftësisë së inspektorit për të interpretuar doktrinën juridike dhe praktikën gjyqësore të identifikuar dhe arsyetimin se si zbatohen ato ndaj fakteve të çështjes në shqyrtim.

**Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Aftësinë për të hulumtuar, identifikuar, analizuar dhe përdorur doktrinën juridike;
- Aftësinë për të hulumtuar, identifikuar, analizuar dhe përdorur standardet dhe parimet ndërkombëtare si KE, Parimet e Bangalores, etj.
- Aftësinë për të hulumtuar, identifikuar, analizuar dhe përdorur praktikën gjyqësore përkatëse, vendore dhe ndërkombëtare, siç janë praktika e unifikuar e Gjykatës së Lartë, praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese, e GJEDNJ-së dhe e gjithë jurisprudenca e konsoliduar, madje edhe në raste kur nuk përbën një burim të ligjit, por shërben për interpretimin e çështjeve konkrete në shqyrtim.

Nëse inspektori mjaftohet vetëm me referencën ndaj doktrinës juridike dhe praktikës gjyqësore, pa dhënë asnjë shpjegim se si ato ndihmojnë për zgjidhjen e çështjes konkrete, mund të jetë tregues i mungesës së aftësive për të përdorur doktrinën juridike dhe për të analizuar praktikën gjyqësore.

**Burimet e vlerësimit:**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë projektvendimet, relacionet apo raportet që përmbajnë analiza ligjore, të hartuara nga inspektori.

**Tabela e pikëzimit të treguesit**

Pikë Totale 13	
Niveli	Pikët
Shkëlqyeshëm	
Shumë mirë	
Mirë	
Mjaftueshëm	
Pamjaftueshëm	

**Burimet e vlerësimit:**

1. Burimi 1;
2. Burimi 2;
3. ....

**Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:**

Referuar burimit 1, rezulton se .....

Referuar burimit 2, rezulton se .....

**c. Aftësia për të ndërtuar logjikisht hetimin në përputhje me kërkesat ligjore (12 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorëve për të ndërtuar hetimet në një mënyrë logjike dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

**Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Aftësinë për të përcaktuar faktet e çështjes;
- Aftësinë për të identifikuar llojin e shkeljes disiplinore;
- Aftësinë për të vendosur mbi veprimet e nevojshme hetimore dhe për t'i zbatuar ato brenda afatit të duhur në mënyrë që të respektojë afatet ligjore të shqyrtimit të ankesës.

**Burimet e vlerësimit:**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë dokumentet ligjore të hartuara nga inspektori dhe të gjitha veprimet hetimore të kryera dhe të dokumentuara nga inspektori.

#### **Tabela e pikëzimit të treguesit**

<b>Pikë Totale 12</b>	
<b>Niveli</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	
Shumë mirë	
Mirë	
Mjaftueshëm	
Pamjaftueshëm	

#### ***Burimet e vlerësimit:***

1. Burimi 1;
2. Burimi 2;
3. ....

#### ***Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:***

Referuar burimit 1, rezulton se .....

Referuar burimit 2, rezulton se .....

#### **d. Aftësia për të mbledhur provat e kërkuara me ligj (12 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorëve për të mbledhur provat që janë të nevojshme për të mbështetur hetimin disiplinor.

#### **Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Aftësinë për të mbledhur provat që janë të nevojshme për të mbështetur objektin e hetimit disiplinor;
- Aftësinë për të administruar provat që janë të nevojshme për të mbështetur objektin e hetimit disiplinor;
- Kapaciteti për të analizuar provat të cilat janë të nevojshme për të mbështetur përfundimet e inspektorit mbi hetimin disiplinor.
- Mbledhja e provave që nuk janë në përputhje me objektin dhe qëllimin e hetimit dhe që nuk kontribuojnë në konkluzionet përfundimtare të hetimit, do të konsiderohet si tregues për mungesën e kapacitetit për të ndërtuar logjikisht hetimin.

#### **Burimet e vlerësimit:**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë të gjitha provat e mbledhura dhe të administruara nga inspektori. Vlerësuesit do të analizojnë me kujdes dosjet e çështjeve të hetimeve disiplinore të ndjekura nga inspektori nën vlerësim.

#### **Tabela e pikëzimit të treguesit**



Pikë Totale 12	
Niveli	Pikët
Shkëlqyeshëm	
Shumë mirë	
Mirë	
Mjaftueshëm	
Pamjaftueshëm	

**Burimet e vlerësimit:**

1. Burimi 1;
2. Burimi 2;
3. ....

**Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:**

Referuar burimit 1, rezulton se .....

Referuar burimit 2, rezulton se .....

**B. Arsyetimi ligjor (50 pikë)**

**a. Saktësia, qartësia dhe kuptueshmëria e projektvendimeve, relacioneve ose raporteve (13 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorit për të hartuar dokumente ligjore të qarta, të sakta, të kuptueshme, të lexueshme.

**Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Përdorimin e thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë të gjuhës;
- Aftësinë për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë të jetë e mundur;
- Zbatimin e saktë të rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës;
- Përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës;
- Përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), paragrafëve dhe e Strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin;
- Aftësinë për të shkruar pa gabime ligjore dhe/ose materiale;
- Përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë.
- Shpeshhtësinë e kthimit të projektvendimit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe saktësinë e përmbushjes së plotësimeve dhe korrigjimeve të kërkuara.

**Burimet e vlerësimit:**

Burimet e vlerësimit për këtë tregues do të jenë dokumentet e hartuara nga inspektori.

**Tabela e pikëzimit të treguesit**

Pikë Totale 13	
Niveli	Pikët
Shkëlqyeshëm	

Shumë mirë	
Mirë	
Mjaftueshëm	
Pamjaftueshëm	

**Burimet e vlerësimit:**

1. Burimi 1;
2. Burimi 2;
3. ....

**Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:**

Referuar burimit 1, rezulton se .....

Referuar burimit 2, rezulton se .....

**b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e arsytimit të projektvendimeve, relacioneve ose raporteve (12 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorëve për të hartuar projektvendimin/relacionin/raportin me një strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar.

**Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi i këtij treguesi do të përqendrohet në faktin nëse struktura e akteve përmban elementet e mëposhtme:

- Prezantimin e fakteve;
- Identifikimin e dispozitave të zbatueshme të ligjit;
- Analizën ligjore të fakteve;
- Përfundimet;
- Dispozitivin e vendimit.

**Burimet e vlerësimit:**

Burimet e vlerësimit të këtij indikator janë projektvendimet, relacionet ose raportet e hartuara nga inspektori.

**Tabela e pikëzimit të treguesit**

Pikë Totale 12	
Niveli	Pikët
Shkëlqyeshëm	
Shumë mirë	
Mirë	
Mjaftueshëm	
Pamjaftueshëm	

**Burimet e vlerësimit:**

1. Burimi 1;
2. Burimi 2;
3. ....

**Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:**

Referuar burimit 1, rezulton se .....

Referuar burimit 2, rezulton se .....

**c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik (13 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorëve për të kryer një analizë cilësore bazuar në një përdorim logjik të koncepteve ligjore.

**Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm:

- Aftësinë për të identifikuar lidhjen shkakësore midis shkeljes së pretenduar, fakteve, provave dhe dispozitave ligjore;
- Aftësinë për të analizuar se si konceptet, institutet dhe dispozitat ligjore lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen në një situatë të caktuar;
- nëse niveli i arsytimit plotëson standardin e procesit të rregullt ligjor;
- nëse përmbajtja është gjithëpërfshirëse, duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve të hetimit disiplinor.

**Burimet e vlerësimit:**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë dokumentet ligjore të hartuara nga inspektori.

**Tabela e pikëzimit të treguesit**

Pikë Totale 13	
Niveli	Pikët
Shkëlqyeshëm	
Shumë mirë	
Mirë	
Mjaftueshëm	
Pamjaftueshëm	

**Burimet e vlerësimit:**

1. Burimi 1;
2. Burimi 2;
3. ....

**Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:**

Referuar burimit 1, rezulton se .....

Referuar burimit 2, rezulton se .....

**d. Aftësia për të marrë në pyetje (12 pikë)**

Ky tregues vlerëson aftësinë e inspektorëve për të zbatuar detyrën e marrjes në pyetje gjatë hetimeve disiplinore.

**Elementet e vlerësimit:**

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- Aftësinë për të mbledhur informacionin përkatës duke kryer intervista dhe duke marrë në pyetje;
- Aftësinë për të analizuar informacionin e mbledhur;
- Aftësinë për të krahasuar gjetjet dhe për të nxjerrë përfundime nga pyetjet e ngritura dhe përgjigjet e marra.

Mbledhja gjatë intervistave e informacionit që dukshëm nuk është në përputhje me qëllimin e hetimit do të konsiderohet si mungesë e kapacitetit për të mbledhur informacionin përkatës.

**Burimet e vlerësimit:**

Burimet e vlerësimit të këtij treguesi do të jenë procesverbalet e intervistave dhe dokumente të tjera të ngjashme të hartuara nga inspektori.

**Tabela e pikëzimit të treguesit**

Pikë Totale 12	
Niveli	Pikët
Shkëlqyeshëm	
Shumë mirë	
Mirë	
Mjaftueshëm	
Pamjaftueshëm	

**Burimet e vlerësimit:**

1. Burimi 1;
2. Burimi 2;
3. ....

**Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:**

Referuar burimit 1, rezulton se .....

Referuar burimit 2, rezulton se .....

**TABELA E PËRGJITHSHME E REZULTATEVE PËR KRITERIN E AFTËSISË PROFESIONALE TË INSPEKTORIT**

Nr.	KRITERET E VLERËSIMIT	NËN KRITERET E VLERËSIMIT	Niveli i aftësisë së inspektorit sipas kriterit të parë	Nr. i pikëve
1.	AFTËSIA PROFESIONALE 100 Pikë	- Njohuritë ligjore 50 pikë	Shkëlqyeshëm	
			Shumë mirë	
			Mirë	
			Mjaftueshëm	
			Pamjaftueshëm	
		- Arsyetimi ligjor 50 pikë	Shkëlqyeshëm	
			Shumë mirë	
			Mirë	
			Mjaftueshëm	
			Pamjaftueshëm	

**2. AFTËSIA ORGANIZATIVE E INSPEKTORIT (100 pikë)**

Inspektori duhet të ketë aftësi të mira organizative në mënyrë që të jetë produktiv. Inspektori nuk mund të jetë efektiv pa pasur aftësinë për të organizuar dhe menaxhuar detyrat gjatë hetimit disiplinor. Produktiviteti varet nga menaxhimi i kohës, që tregon se sa efektivisht e përdor inspektori kohën, si kur inspekton i vetëm, ashtu edhe në grup me inspektorë të tjerë.

Inspektori duhet të bëjë përpjekjen maksimale si në menaxhimin efektiv të kohës, ashtu dhe në planifikimin e punës, pa krijuar pengesa në ecurinë e punës.

**A. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës (40 pikë)**

**a. Respektimi i afateve ligjore dhe plotësimi i standardeve minimale kohore (8 pikë)**

